



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2022

VENDIM
Nr. 33, datë 26.01.2022

PËR
VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {...} PËR PERIUdhËN
2017 - 2019

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 85, 89 dhe 95, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën 2017- 2019”, i hartuar nga relator z. Erjon Muharremaj,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën 2017- 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI.

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarës {...} në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarës bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtarës pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.

1.A Njohuritë ligjore.

1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

Roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” – “*Gjykata e njeh ligjin*”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, natyrën juridike të saj dhe referencën relevante që gjen zbatim në zgjidhjen e çështjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

Në lidhje me përcaktimin e fakteve të çështjes, gjyqtarja referuar objektit të mosmarrëveshjes, natyrës së çështjes (civile themeli, familjare, kërkesë civile, gjykim penal themeli, kërkesë e seancës paraprake ose kërkesë penale)¹ apo llojit të gjykimit të zhvilluar në çështjet penale (gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar), i kushton rëndësi të veçantë përshkrimit të detajuar dhe analitik të fakteve të çështjes, si të atyre me natyrë procedurale, ashtu edhe të fakteve që lidhen me themelin, duke i parashtruar ato respektivisht në pjesën e parë dhe të dytë të arsytimit të vendimit.

Paraqitja e rrethanave procedurale përbën pjesën hyrëse të arsytimit të vendimit, në një nënndarje të titulluar “Procedura”, në të cilën parashtrohet, përveç vlerësimit të gjykatës në lidhje me juridiksionin gjyqësor, kompetencën lëndore dhe tokësore, përbërjen e trupit

¹ Vendimi nr. 49, datë 11.06.2019, vendimi nr. 61/1, datë 05.12.2019 dhe vendimi nr. 71, datë 01.11.2019.

gjykues, evidentohet sipas rastit ecuria procedurale e çështjes lidhur me (i) shqyrtimin e kërkesave të palëve gjatë gjykimit për marrjen e masës së sigurimit të padisë,² (ii) vlerësimi ligjor i gjykatës lidhur me elementë të kompetencës lëndore ose tokësore në shqyrtimin e çështjes kur ato janë bërë objekt diskutimi gjatë gjykimit, (iii) ecuria procedurale e gjykimit në rastet kur është ndryshuar përbërja e trupit gjykues,³ (iv) vlerësimi i gjykatës lidhur me kërkesa të palëve për ndryshimin e ndërgjyqësisë, thirrjen në gjykim të personit të tretë apo shqyrtimin e kërkesës për ndërhyrje kryesore në gjykim,⁴ etj. Në disa nga çështjet civile objekt shqyrtimi, referuar natyrës së vendimit, gjyqtarja është ndalur vetëm në pasqyrimin dhe analizën e fakteve me natyrë procedurale, kryesisht të atyre lidhur me ndryshimin e objekti të padisë, njoftimin dhe pasojat e mosparaqitjes së palëve, përcaktuar kjo nga natyra e vendimit gjyqësor, i cili është vendim për pushimin e gjykimit të çështjes, për shkak të mosparaqitjes së palëve.⁵

Në vendimet penale burim vlerësimi, rrethanat që lidhen me ecurinë procedurale të gjykimit analizohen në pjesën hyrëse të arsytimit të vendimit, duke i kushtuar rëndësi përveç vlerësimit të gjykatës lidhur me elementët proceduralë që lidhen me juridiksionin, kompetencën lëndore dhe tokësore, përbërjen e trupit gjykues (elementë të cilët analizohen në çdo vendim), edhe paraqitjes dhe vlerësimit lidhur me kërkesat procedurale të palëve, sikurse është rasti i kërkesave për procedim me gjykim të shkurtuar,⁶ njoftimin dhe pjesëmarrjen e të pandehurit në gjykim,⁷ etj. Në çështjet penale të seancës paraprake gjyqtarja përshkruan ecurinë procedurale të çështjeve sa i përket njoftimit të palëve, sipas parashikimeve të K.Pr.Penale, si dhe të drejtave procedurale të tyre, shqyrtimin e fakteve lidhur me pavlefshmërinë e akteve apo papërdorshmërinë e provave, në rastet e kërkesave për dërgimin e çështjes në gjyq, si dhe vlerësimin lidhur me aspektet procedurale të paraqitjes së kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar.⁸

Menjëherë pas përshkrimit dhe analizës së rrethanave me karakter procedural, gjyqtarja parashtron rrethanat e faktit objekt gjykimi, në një nënndarje të titulluar “Rrethanat dhe faktet e çështjes” në çështjet penale, ose “Fakti penal dhe provat” në çështjet civile, duke i parashtruar ato në mënyrë të plotë, të qartë dhe duke integruar përmbajtjen e provave dhe analizën e tyre, së bashku me faktin, në varësi të volumit të rrethanave të faktit apo të natyrës së gjykimit, sipas kërkesës objekt shqyrtimi.

Në të gjitha vendimet burim vlerësimi të cilat lidhen me shqyrtimin e çështjeve të themelit (*penale, civile ose familjare*) përshkrimi i fakteve me natyrë procedurale, shoqëruar me

² Vendimi nr. 316, datë 06.04.2017.

³ Vendimi nr. 1237, datë 27.12.2019 dhe vendimi nr. 267, datë 27.03.2018.

⁴ Vendimi nr. 720, datë 25.07.2017 dhe vendimi nr. 267, datë 27.03.2018.

⁵ Vendimi nr. 296, datë 05.04.2018.

⁶ Vendimi nr. 132, datë 13.03.2017, vendimi nr. 180, datë 18.04.2017, vendimi nr. 235, datë 25.07.2018 dhe vendimi nr. 311, datë 24.10.2019.

⁷ Vendimi nr. 180, datë 18.04.2017.

⁸ Vendimi nr. 438, datë 31.10.2019 dhe vendimi nr. 353, datë 27.09.2018.

vlerësimin dhe analizën ligjore të gjykatës lidhur me këto elementë, posaçërisht në rastet kur ato konsistojnë në shqyrtimin e kërkesave procedurale të palëve, i jep qartësi vendimit dhe orienton lexuesin lidhur me elementë të tillë, si: objekti i padisë, shkaku ligjor i saj, ndërgjyqësia, procedura e gjykimit (*gjykim i shkurtuar apo i zakonshëm në çështjet penale*), zhvillimi i gjykimit në prezencë ose mungesë të palëve, etj.

Pas përshkrimit dhe analizës së fakteve me natyrë procedurale, gjyqtarja parashtron dhe analizon në mënyrë të detajuar faktet thelbësore të çështjes, duke i paraqitur ato në mënyrë të qartë, në një rend logjik dhe duke integruar në përmbajtje të faktit, provat përkatëse të analizuara në raport me njëra tjetrën, mbi të cilat gjyqtarja ka konkluduar lidhur me faktet konkrete. Pra, në secilin vendim burim vlerësimi, faktet e çështjes janë përshkruar dhe analizuar në mënyrë tepër të detajuar dhe të plotë, duke u shoqëruar në çdo rast me paraqitjen dhe analizën e provave të administruara në gjykim, në mbështetje të konkluzioneve të gjyqtarës lidhur me provueshmërinë e fakteve thelbësore të çështjes.

Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes, në të gjitha vendimet e analizuar, gjyqtarja identifikon dhe përcakton qartë dhe në mënyrë të shprehur natyrën e çështjes objekt shqyrtimi, menjëherë pas paraqitjes së rrethanave procedurale dhe analizës së faktit, në çështjet civile, ndërsa në çështjet penale, natyra e çështjes përcaktohet që në pjesën e parë të arsytimit të vendimit, referuar specifikave të çështjeve konkrete, siç janë rastet e çështjeve të seancës paraprake, në të cilat objekti i shqyrtimit rezulton të përcaktohet që në pjesën hyrëse të arsytimit, duke orientuar edhe natyrën e procedimit të zhvilluar, si dhe faktet që do të jenë objekt vlerësimi në vijim të arsytimit. Përcaktimit të saktë të natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve i jepet rëndësia e duhur nga ana e gjyqtarës, duke u bërë në mënyrë të shprehur, e në disa raste, si pasojë e një analize ligjore të shkakut dhe objektit të padisë, posaçërisht në çështjet civile, pasi ky përcaktim ka lidhje të drejtpërdrejtë me kompetencën në lëndë dhe funksion të saj, duke cituar dhe analizuar për këtë qëllim edhe dispozitat procedurale,⁹ në lidhje me kompetencën lëndore dhe tokësore për shqyrtimin e çështjes.

Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm, në të gjitha vendimet gjyqësore burim vlerësimi rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përcaktuar qartë ligjin e zbatueshëm, duke cituar në përmbajtjen e vendimit dispozitat e ligjit procedural dhe material, të cilat merren në analizë në lidhje me zgjidhjen e çështjeve të karakterit procedural, apo zgjidhjen në themel të çështjes.

Sa i përket ligjit procedural:

Në çështjet civile, gjyqtarja identifikon dhe referon në pjesën arsytuese të vendimit, dispozitat procedurale, si më poshtë:

- nenet 6, 14, 16/1 dhe 28 të K.Pr.Civile, lidhur me kufijtë e shqyrtimit të çështjes civile, detyrimin e gjykatës për t'u shprehur për gjithçka që kërkohet, si dhe të drejtën që ka gjykata për të bërë një cilësim të ndryshëm të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur

⁹ Vendimi nr. 1237, datë 27.12.2019.

me përcaktimin që mund të propozojnë palët,¹⁰ si dhe nenin 181/2 të K.Pr.Civile lidhur me vlerësimin për fazën e gjykimit, në rastet e ndryshimit të trupit gjykues;¹¹

- nenet 35, 36/1, 41, 43, 45, 47/1, 52, 54,56, 59/1, 609 dhe 610 të K.Pr.Civile, lidhur me përcaktimin e juridiksionit gjyqësor, kompetencës lëndore dhe tokësore të gjykatës në shqyrtimin e mosmarrëveshjeve, referuar objektit të tyre (çështje me objekt pavlefshmëri titulli ekzekutiv, kundërshtim veprimesh përmbartimore, njohje pronar, kthim shume, marrëdhënie pune, etj.);¹²
- nenet 224/a dhe 105/1/2 të K.Pr.Civile lidhur me caktimin e ekspertit dhe urdhërimin për pagimin e shpenzimeve për ekspertimin në mënyrë të detyrueshme nëpërmjet shërbimit përmbartimor, nenet 609 dhe 610 të K.Pr.Civile, lidhur me pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv dhe kundërshtimin e veprimeve përmbartimore¹³ dhe nenin 161/c të K.Pr.Civile lidhur me shtimin e ndërgjyqësisë pasive;¹⁴
- nenet 189, 90 dhe 190 të K.Pr.Civile, lidhur me thirrjen e personit të tretë dhe pranimin e ndërhyrjes kryesore në gjykim, nenet 8 dhe 12 të K.Pr.Civile, lidhur me përcaktimin e barrës së provës, nenet 253, 233/b të K.Pr.Civile, lidhur me përcaktimin e fuqisë provuese të akteve zyrtare dhe përkufizimin e “fillimit të provës me shkresë”, nenin 70 të K.Pr.Penale, lidhur me efektin e vendimeve penale në procesin civil,¹⁵ si dhe nenet 102, 106 dhe 105 të K.Pr.Civile, lidhur me përcaktimin e detyrimit për pagimin e shpenzimeve gjyqësore;¹⁶
- nenin 185 të K.Pr.Civile lidhur me ndryshimin e objektit të padisë,¹⁷ nenet 297, 201, 179, 299 të K.Pr.Civile lidhur me pezullimin e gjykimit, pasojat e heqjes dorë nga gjykimi i padisë dhe pasojat e mosparaqitjes së palëve në gjykim, pa shkaqe të përligjura.¹⁸

Në çështjet familjare (me objekt zgjidhje martesë, heqje e përgjegjësisë prindërore dhe lëshim i urdhrin të mbrojtjes) gjyqtarja identifikon ligjin e zbatueshëm procedural, duke referuar dispozitat si vijon:

- nenet 25, 36/1, 32, 42, 41, 51, 54, 158/a, 158/b, 158/c, 158/c, 201, 299, të K.Pr.Civile, dekretin e Presidentit të Republikës nr. 6201, datë 08.06.2009, në lidhje me përcaktimin e kompetencës dhe juridiksionit gjyqësor për shqyrtimin e çështjes, ecurinë procedurale të çështjes, zhvillimin e veprimeve paraprake dhe seancës së pajtimit, pushimin e gjykimit në rastet e heqjes dorë nga pala paditëse për një nga kërkimet objekt padie;¹⁹
- nenet 21 pika 1, 18 pika 1, 13, 19 të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, lidhur me aspektet procedurale të shqyrtimit të çështjes për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes,

¹⁰ Vendimi nr. 316, datë 06.04.2017.

¹¹ Vendimi nr. nr. 1237, datë 27.12.2019.

¹² Vendimi nr. 316, datë 06.04.2017, vendimi nr. 720, datë 25.07. 2017, vendimi nr. 267, datë 27.03.2018, vendimi nr. 1237, datë 27.12.2019, Vendimi nr. 967, datë 10.11.2017.

¹³ Vendimi nr. 316, datë 06.04.2017.

¹⁴ Vendimi nr. 316, datë 06.04.2017 dhe vendimi nr. 720, datë 25.07.2017.

¹⁵ Vendimi nr. 267, datë 27.03.2018.

¹⁶ Vendimi nr. 267, datë 27.03.2018. Sa i përket dispozitave për shpenzimet gjyqësore, ato referohen në çdo vendim civil burim vlerësimi.

¹⁷ Vendimi nr. 967, datë 10.11.2017.

¹⁸ Vendimi nr. 1070, datë 04.12.2017 dhe vendimi nr. 296, datë 05.04.2018.

¹⁹ Vendimi nr. 516, datë 12.06.2018, vendimi nr. 1180, datë 28.12.2017, vendimi nr. 589, datë 03.07.2018 dhe vendimi nr. 97, datë 03.08.2018.

legjitimitetin e palëve, kompetencën e gjykatës për shqyrtimin e çështjes, afatin e caktimit të seancës së verifikimit, etj;²⁰

Në çështjet penale, referuar natyrës së çështjes (*çështje penale e fazës së hetimit, seancës paraprake ose themelit*), apo ritit të gjykimit (*gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar*), gjyqtarja identifikon dispozitat procedurale, si më poshtë:

- nenet 6, 13/3, 34/a, 48,74,76 të K.Pr.Penale dhe dekretin e Presidentit të Republikës nr.6201, datë 08.06.2009, lidhur me përcaktimin e përbërjes së trupit gjykues, të drejtat e të pandehurit, të drejtën e mbrojtjes, juridiksionin gjyqësor, kompetencën lëndore dhe tokësore të gjykatës në shqyrtimin e çështjes;²¹
- nenet 128 të K.Pr.Penale, lidhur me pavlefshmërinë e akteve, nenet 224, 403 dhe 405 të K.Pr.Penale, lidhur me procedimin me gjykim të shkurtuar, nenin 406 të K.Pr.Penale, lidhur me mënyrën e caktimit të dënimit në rastet e procedimit me këtë lloj të posaçëm të gjykimit, si dhe nenin 485 të K.Pr.Penale, lidhur me shpenzimet gjyqësore në procesin penal;²²
- nenet 348, 349 dhe 340/4 të K.Pr.Penale, lidhur me njoftimin dhe pjesëmarrjen e të pandehurit në gjykim;²³
- nenin 390 dhe 393 të K.Pr.Penale, lidhur me vendimin e dënimit në rastet kur i pandehuri deklarohet fajtor;²⁴
- nenet 228, 229, 230, 244, 246, 249, 258, 260 dhe 278 të K.Pr.Penale, lidhur me kushtet dhe kriteret e caktimit dhe zëvendësimit të pasave të sigurimit personal;²⁵
- nenet 69, 74, 13/2, 76, 332-332/gj të K.Pr.Penale, lidhur me juridiksionin, kompetencën tokësore dhe lëndore, kompetencën funksionale të gjyqtarit të seancës paraprake në shqyrtimin e kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq; nenin 34/a të K.Pr.Penale, lidhur me të drejtat e të pandehurit në seancë paraprake, nenet 48 dhe 49 të K.Pr.Penale, lidhur me të drejtën e mbrojtjes dhe nenet 332/b, 332/c, 332/dh, 332/ë, 332/f të K.Pr.Penale, lidhur me shqyrtimin dhe vlerësimin e gjykatës në seancë paraprake, disponimin me vendim për dërgimin e çështjes në gjyq, formimin e fashikullit të gjykimit dhe depozitimin e dosjes për t'iu nënshtruar procedurave të shortit;²⁶
- nenet 328, 329, 329/a, 329/b dhe 329/c të K.Pr.Penale, lidhur me aspektet procedurale të shqyrtimit të kërkesës për pushimin e procedimit penal dhe rastet e pushimit të procedimit.²⁷

Sa i përket ligjit material të zbatueshëm, referuar burimeve të vlerësimit në tërësinë e tyre, rezulton se gjyqtarja identifikon dhe/ose citon ligjin e zbatueshëm, duke treguar gjithashtu kujdes në shmangien e citimit apo të listimit të dispozitave ligjore materiale të cilat nuk kanë lidhje dhe nuk referojnë drejtpërdrejt në zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi. Duke

²⁰ Vendimi nr. 97, datë 03.08.2018 dhe vendimi për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes datë 27.07.2018.

²¹ Dispozitat si më sipër identifikohen thuajse në të gjitha vendimet penale burim vlerësimi.

²² Vendimi nr. 311, datë 24.10.2019, vendimi nr. 132, datë 13.03.2017, vendimi nr. 180, datë 18.04.2017 dhe vendimi nr. 235, datë 25.07.2018.

²³ Vendimi nr. 180, datë 18.04.2017.

²⁴ Vendimi nr. 235, datë 25.07.2018, vendimi nr. 132, datë 13.03.2017, vendimi nr. 180, datë 18.04.2017, etj.

²⁵ Vendimi nr. 198, datë 27.07.2017.

²⁶ Vendimi nr. 353, datë 27.09.2018 dhe vendimi nr. 438, datë 31.10.2019.

²⁷ Vendimi nr. 4, datë 04.10.2017.

i ndarë vendimet gjyqësore objekt vlerësimi në dy kategori: (i) vendime civile/familjare dhe (ii) vendime penale, në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm material, konstatohet se: **Në vendimet civile** (me objekt shpërblim dëmi, pavlefshmëri veprimi juridik, marrëdhënie pune, njohje pavërtetësi dokumenti, pavlefshmëri titulli ekzekutiv dhe kundërshtim veprimi përmbartimor, njohje e vërtetësisë së dokumentit, zgjidhje martese, heqja e zotësisë prindërore, etj.), gjyqtarja identifikon ligjin material të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, duke iu referuar si dispozitave materiale të Kodit Civil dhe Kodit të Familjes, ashtu edhe ligjeve të posaçme apo akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës, që kanë lidhje kryesisht me:

- *Pavlefshmërinë e titujve ekzekutiv të faturave të energjisë elektrike, dhe kundërshtimin e veprimeve përmbartimore*, ku gjyqtarja identifikon dispozitat ligjore materiale dhe procedurale (nenin 609 dhe 610 të K.Pr.Civile) në lidhje me normën ligjore të zbatueshme për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv; nenet 450, 502, 506 dhe 702 të Kodit Civil, lidhur me rastet e zgjidhjes së kontratës, shpërblimin e dëmit në rastet të mospërmbushjes së detyrimit, cedimin e kredisë. Po ashtu, në këtë vendim identifikohen si ligj i zbatueshëm dispozita të ligjeve të posaçme, si ligji nr. 8730, datë 18.01.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit përmbartimor privat” dhe ligji nr. 48/2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare”, lidhur me vlerësimin e fushës së zbatimit të këtij ligji, në raport me marrëdhënien juridike objekt gjykimi.²⁸
- *Fitimin e pronësisë me parashkrim fitues pa titull*, ky gjyqtarja identifikon nenet 149, 163, 168, 169, 170, 193, 196, 304, 306 dhe 307 të Kodit Civil, lidhur me mënyrat e fitimit të pronësisë, fitimin e pronësisë me parashkrim fitues me dhe pa titull, kushtet ligjore të fitimit të pronësisë nëpërmjet kësaj mënyre, institutin e mirëbesimit, etj. Po ashtu, gjyqtarja identifikon edhe dispozita të ligjit “Për regjistrimin e pasurisë të paluajtshme”, në lidhje me detyrimin për regjistrim të vendimit.²⁹
- *Lidhur me padinë e detyrimit për kthimin e shumës dhe shpërblimin e dëmit*, gjyqtarja identifikon si ligj të zbatueshëm nenin 80 të Kodit Civil lidhur me formën e veprimeve juridike, nenet 114, 115/dh, 118, 125 të Kodit Civil lidhur me parashkrimin e padisë, nenet 419, 420, 450, 660, 663, 676, 681, 682, 690, 693, 698, 1050 të Kodit Civil lidhur me detyrimet kontraktore, mospërmbushjen e tyre, vlefshmërinë e kontratës, fuqinë detyruese të saj, kontratën specifike të huasë, etj.³⁰
- *Padinë e njohjes në referim të nenit 32/b të K.Pr.Civile*, ku gjyqtarja në mbështetje të arsyetimit të saj lidhur me njohjen e marrëdhënies së punës, identifikon si ligj të zbatueshëm edhe nenin 7 të Kodit të Punës.³¹
- *Shpërblimin e dëmit që buron nga zgjidhja e marrëdhënies së punës*, ku gjyqtarja identifikon si ligj të zbatueshëm nenet 3, 4, 5, 7, 12, 21, 22-26, 71, 72, 73, 107, 140, 141, 143, 144, 146, 147, 149, 153, 155 të Kodit të Punës, në funksion të përkufizimit të marrëdhënies juridike të punës, të drejtave të palëve, llojin e kontratës, formën dhe përmbajtjen e saj, rastet, procedurën,

²⁸ Vendimi nr. 316, datë 06.04.2017.

²⁹ Vendimi nr. 720, datë 25.07.2017.

³⁰ Vendimi nr. 267, datë 27.03.2018.

³¹ Vendimi nr. 967, datë 10.11.2017.

afatin dhe shkaqet e zgjidhjes së kontratës dhe pasojave që vijnë prej zgjidhjes së marrëdhënies së punës.³²

- *Padinë e saktësimi të kufijve*, duke identifikuar nenin 157 të Kodit Civil që parashikon këtë padi specifike me qëllim analizimin e përmbajtjes së saj, në raport me pretendimet e palës paditëse.³³
- *Në kërkesën për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit*, krahas nenit 510 të K.Pr.Civile, i cili referohet për të përcaktuar cilësinë e kontratës së dhënies së kredisë si titull, referohet edhe neni 2 i ligjit nr. 52/2016, “Për shoqëritë e kursim kreditit dhe unionet e tyre” dhe neni 4 i ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.³⁴
- *Zgjidhjen e martesës dhe pasojat që rrjedhin prej saj*,³⁵ gjyqtarja identifikon dhe citon dispozitat ligjore familjare (*nenet 1, 2, 3, 5, 6, 14, 16, 50, 123, 125, 129, 132, 133, 134, 143, 146 e vijues të Kodit të Familjes*) në lidhje me zgjidhjen e martesës ligjore ndërmjet palëve dhe zgjidhjen e pasojave që rrjedhin prej saj në lidhje me bashkëshortët dhe fëmijët e mitur, si dhe ligjin nr. 10129, datë 11.05.2009, “Për gjendjen civile”, lidhur me regjistrimin e vendimit për zgjidhjen e martesës.
- Në lidhje me heqjen e përgjegjësisë prindërore, referon nenet 2, 215, 228 dhe 267 të Kodit të Familjes dhe në lidhje me kushtet dhe kriteret për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes dhe verifikimin e tij, identifikon si ligj të zbatueshëm, si në aspektin procedural ashtu edhe atë material, dispozita të ligjit të posaçëm nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar.

Krahas dispozitave të Kodit Civil, Kodit të Familjes, Kodit të Punës, dhe ligjeve të posaçme si më sipër, gjyqtarja ka identifikuar dhe referuar si ligj të zbatueshëm edhe një sërë dispozitash të Kushtetutës dhe akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës:

- nenet 11, 41 dhe 42³⁶ të Kushtetutës dhe nenin 1 të protokollit 1 të KEDNJ lidhur me të drejtën e pronësisë dhe mbrojtjen e saj;³⁷
- nenin 53 të Kushtetutës, nenet 8 dhe 2 të KEDNJ dhe Konventën dhe Deklaratën për të Drejtat e Fëmijës, në çështjet me objekt zgjidhje martesë, në lidhje me të drejtën për jetë private dhe familjare, si dhe parimin e interesit më të lartë të fëmijës;³⁸
- nenet 4, 7 dhe 9 të Konventës së ILO³⁹ “Mbi përfundimin e marrëdhënies së punës”, në lidhje me përfundimin e marrëdhënies së punës;⁴⁰
- nenin 42 të Kushtetutës dhe neni 6 të KEDNJ lidhur me parimin e procesit të rregullt ligjor.⁴¹

³² Vendimi nr. 1237, datë 27.12.2019.

³³ Vendimi nr. 998, datë 15.11.2017.

³⁴ Vendimi nr. 232, datë 16.07.2018.

³⁵ Vendimi nr. 516, datë 12.06.2018, vendimi nr. 1084, datë 07.12.2017 dhe vendimi nr. 589, datë 03.07.2018.

³⁶ Neni 42 i Kushtetutës referohet edhe në vendimin nr. 267, datë 27.03.2018.

³⁷ Vendimi nr. 720, datë 25.07.2017.

³⁸ Vendimi nr. 516, datë 12.06.2018, vendimi nr. 589, datë 03.07.2018 dhe vendimi nr. 1084, datë 07.12.2017.

³⁹ Organizatës Ndërkombëtare të Punës.

⁴⁰ Vendimi nr. 1237, datë 27.12. 2019.

⁴¹ Vendimi nr. 998, datë 15.11.2017 dhe vendimi nr. 296, datë 05.04.2018.

Në vendimet penale, gjyqtarja identifikon dispozitat materiale penale të sanksionuara në pjesën e posaçme të Kodit Penal, në funksion të analizimit dhe vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal që i atribuohet të pandehurit, si edhe dispozitave të përgjithshme të Kodit Penal, si më poshtë:

- Identifikon në funksion të cilësimit juridik të faktit penale: nenin 279/2 të K.Penal në lidhje me veprën penale *“Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta”*, duke identifikuar edhe dispozita të ligjit nr. 99/2013 *“Për armët”*;⁴² nenin 121/a/2 të K. Penal në lidhje me akuzën e *“Përndjekjes”*⁴³ në funksion të analizës së elementëve të figurës së veprës penale apo të vlerësimit të dyshimit të arsyeshëm në lidhje me ekzistencën e kësaj vepre;⁴⁴ nenin 197 të K.Penal në lidhje me akuzën e *“Organizimit të lotarive të palejuara”*;⁴⁵ nenin 134ë K.Penal në lidhje me veprën penale të *“Vjedhjes”*; nenin 291 të Kodit Penal në lidhje me akuzën për veprën penale *“Drejtimi i mjetit në mënyrë të parregullt”*⁴⁶ dhe nenin 283/2 të Kodit Penal në lidhje me veprën penale *“Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”*.⁴⁷
- Në çdo rast, referohen dispozita të Kodit Penal, të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, p.sh. në lidhje me parimin e mosdënimit pa ligj (neni 4 i K.Penal), moshën për përgjegjësi penale (neni 12 i Kodit Penal), qëllimin e dënimit penal (neni 1/b i Kodit Penal), kriteret dhe parimet në caktimin e llojit dhe masës së dënimit (neni 47 i K. Penal),⁴⁸ rrethanat lehtësuese dhe rënduese (nenet 48, 49 dhe 50 të K. Penal), dispozitat lidhur me dënimet alternative (neni 59 dhe 63 i Kodit Penal),⁴⁹ institutin e bashkëpunimit dhe përgjegjësinë e bashkëpunëtoreve (neni 25 dhe 27 i Kodit Penal),⁵⁰ etj.
- Gjyqtarja identifikon si ligj të zbatueshëm edhe dispozita të ligjeve të posaçme, në funksion të argumentimit lidhur me anën objektive të veprave penale, konkretisht: ligjin nr.99/2013, *“Për armët”*,⁵¹ ligjin nr. 7975, datë 26.07.1995, *“Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”*,⁵² ligjin nr.8378, datë 22.07.1998, *“Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”*.⁵³

Krahas dispozitave të Kodit Penal dhe ligjeve të posaçme si më sipër, gjyqtarja ka identifikuar dhe referuar si ligj të zbatueshëm edhe një sërë dispozitash të Kushtetutës dhe akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës:

- nenet 15⁵⁴, 42/2 dhe 53⁵⁵ të Kushtetutës, lidhur me natyrën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, parimin e procesit të rregullt ligjor dhe të drejtën për jetë private dhe familjare;⁵⁶

⁴² Vendimi nr. 311, datë 24.10.2019.

⁴³ Vendimi nr. 235, datë 25.07.2018.

⁴⁴ Vendimi nr. 198, datë 27.07.2017

⁴⁵ Vendimi nr. 353, datë 27.09.2018.

⁴⁶ Vendimi nr.180, datë 18.04.2017.

⁴⁷ Vendimi nr. 132, datë 13.03.2017.

⁴⁸ Këto dispozita referohen në të gjitha vendimet penale të themelit.

⁴⁹ Vendimi nr. 311, datë 24.10.2019, vendimi nr. 180, datë 18.04.2017.

⁵⁰ Vendim nr. 132, datë 13.03.2017.

⁵¹ Vendimi nr. 311, datë 24.10.2019.

⁵² Vendimi nr. 132, datë 13.03.2017.

⁵³ Vendimi nr. 180, datë 18.04.2017.

⁵⁴ Neni 15 i Kushtetutës referohet dhe në vendimet me objekt *“Dërgimin e çështjes në gjyq”* me nr. 353, datë 27.09.2018 dhe nr. 438, datë 31.10.2019.

- nenet 15, 17, 27, 28 dhe 30 të Kushtetutës dhe nenet 3, 4, 5 dhe 6 të KEDNJ, në lidhje me parimet e përgjithshme për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të drejtën për liri dhe siguri, të drejtën për proces të rregullt ligjor, ndalimin e torturës, skllavërisë dhe punës së detyruar,⁵⁷ në kuadër të vlerësimit lidhur me kufizimin e të drejtave për shkak të procedimit penal;
- nenin 148 të Kushtetutës, lidhur me përcaktimin e funksionit kushtetutës të organit të Prokurorisë.⁵⁸

Sa i përket konfliktit të normave, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtarja ndonjë rast i konfliktit të normave ligjore për të evidentuar mënyrën dhe se si do të gjente zbatim një konflikt i tillë në rastin konkret. Nga ana tjetër, nuk konstatohet asnjë rast ku analiza e konfliktit të normave të ketë qenë e domosdoshme, në mbështetje të arsyetimit lidhur me zgjidhjen e çështjes. Vetëm në një rast, duket se gjyqtarja ka evidentuar një konflikt *në dukje* të normave materiale, duke analizuar natyrën e marrëdhënies juridike të detyrimit që buron nga kontrata e huasë me institucionet financiare jo bankare, në raport me veprimet juridike tregtare, sipas përcaktimit të nenit 2, të ligjit nr.48/2012, me qëllim përcaktimin e ligjit të zbatueshëm në lidhje me përcaktimin e masës së kamatës ligjore për shkak të mospërmbushjes në kohë të detyrimit.⁵⁹

Në tërësi, spikat aftësia e gjyqtarës për paraqitjen dhe analizën e plotë të fakteve, si të atyre me natyrë procedurale, në të cilat jepet një panoramë e qartë e ecurisë së çështjes dhe veprimeve të kryera, së bashku me analizën ligjore, në rastet kur elementët proceduralë lidhen në trajtimin e kërkesave të palëve, ashtu edhe të fakteve thelbësorë të çështjes, të cilët paraqiten në mënyrë të detajuar, të plotë dhe analitike, duke integruar provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor të tyre. Gjithashtu, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, si dhe në përcaktimin e qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin e arsyetimit dhe analizës ligjore lidhur me zgjidhjen e çështjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës në treguesin “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

⁵⁵ Vendimi nr. 235, datë 25.07.2018.

⁵⁶ Vendimi nr. 311, datë 24.10.2019 dhe vendimi nr. 235, datë 25.07.2018.

⁵⁷ Vendimi nr. 198, datë 27.07.2017.

⁵⁸ Vendimi nr. 4, datë 04.10.2017.

⁵⁹ Vendimi nr. 316, date 06.04.2017.

1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.

Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike (*procedurale dhe materiale - civile apo penale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi, duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtarja lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore citohen duke u shoqëruar në çdo rast me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes, si në ato me natyrë procedurale, ashtu edhe në ato që kanë lidhje me themelin e çështjes. Tipar karakteristik i gjyqtarës është se në çdo rast citimi ose referimi i dispozitave është shoqëruar me interpretimin e tyre në mënyrë abstrakte, para aplikimit mbi faktin konkret, ose konkluzionin e arritur. Konstatohet se gjyqtarja kryesisht përdor interpretimin teleologjik të normës konkrete, duke identifikuar qëllimin për të cilën ajo është krijuar, por edhe interpretimin literal apo sistematik të normave, interpretim i cili duke e përjasur me faktin juridik të nxjerrë nga analiza e provave të shqyrtuara, sjell si pasojë logjike konkluzionin e saj në lidhje me zgjidhjen e çështjes.

- Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm

Në vendimet civile përgjithësisht interpretimi i normës juridike bëhet jo vetëm në aspektin teorik të saj, duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative ose alternative, që të gjejë zbatim norma konkrete, por edhe në përputhje me faktin dhe provat e administruara në gjykim. Në mënyrë më specifike, në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi evidentohet se gjyqtarja:

- Merr në analizë mjetet e mbrojtjes në fazën e ekzekutimit, duke analizuar përmbajtjen dhe qëllimin e neneve 609 dhe 610 të K.Pr.Civile, në lidhje me pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv dhe kundërshtimin e veprimeve përmbare, duke interpretuar këto dispozita në mënyrë të pavarur, duke analizuar kushtet ligjore të pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv dhe rastet e kundërshtimit të veprimeve përmbare, konceptin e titullit ekzekutiv dhe natyrën e tij në raport edhe me parimin e sigurisë juridike, shkakun ligjor dhe afatin e kundërshtimit të veprimeve përmbare dhe subjektet që legjitimohen për të ngritur kërkimet respektive në fazën e ekzekutimit. Në shërbim të analizës lidhur me kërkimin për kundërshtimin e veprimeve përmbare, gjyqtarja referon edhe në përkufizimin e veprimit juridik tregtar, sipas përcaktimeve të nenit 2, të ligjit nr. 48/2014, duke evidentuar dhe analizuar gjerësisht qëllimin e këtij ligji dhe fushën e zbatimit të tij.⁶⁰
- Në interpretim të dispozitave materiale (*neneve 168-169-170 dhe 306 të K.Civil*) gjyqtarja analizon padinë për fitimin e pronësisë me parashkrim fitues pa titull, duke interpretuar dispozitat në drejtim të përcaktimit të natyrës së kësaj padie, natyrës së mënyrës së fitimit të pronësisë nëpërmjet kësaj forme origjinale, kushtet ligjore që duhet të provohen për ekzistencën e saj, legjitimitetin e palës paditëse dhe të palës së paditur,

⁶⁰ Vendimi nr. 316, datë 06.04.2017.

- si dhe analizën e institutit të mirëbesimit, të analizuar në drejtim të prezumimit, por edhe të provueshmërisë së tij, gjatë kohës së posedimit të sendit.⁶¹
- Duke interpretuar nenet 80, 419, 420, 450, 663, 118, 481 dhe 1050 të Kodit Civil, gjyqtarja merr në analizë natyrën e marrëdhënies juridike të detyrimit në përgjithësi; natyrën dhe formën e veprimeve juridike për efekt të vlefshmërisë ose provueshmërisë; kushtet thelbësore për ekzistencën dhe vlefshmërinë e marrëdhënies juridike të detyrimit; marrëdhënie juridike specifike që buron nga kontrata e huasë; formën e kontratës dhe rëndësinë e saj për vlefshmërinë ose provueshmërinë e marrëdhënies; konceptimin e faktit juridik krijues dhe shues; barrën e provës për subjektet e marrëdhënies juridike në lidhje me ekzistencën e këtyre fakteve; rastet e mospërmbushjes së detyrimeve kontraktore, si dhe pasojat që vijnë prej tyre, duke u ndaluar në secilën dispozitë, nëpërmjet zbërthimit të saj (*nëpërmjet identifikimit të qëllimit, përmbajtjes, kushteve dhe kriterëve ligjore të aplikimit të saj, etj.*). Gjithashtu, duke iu referuar konkluzioneve mbi formën e kontratës, gjyqtarja ndalet dhe interpreton në mënyrë të detajuar dispozitat e ligjit procedural dhe material lidhur me barrën e provës për ekzistencën e marrëdhënies kontraktore mes palëve dhe mos përmbushjen e detyrimeve që burojnë prej saj. Në përgjigje të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, gjyqtarja ndalet gjerësisht në interpretimin e neneve 125, 115 shkronja dh), 112, 114 dhe 118 të Kodit Civil lidhur me parashkrimin e padisë për kërkimin e dëmit kontraktor, duke analizuar institutin e parashkrimit të padisë, afatin e parashkrimit, momentin e fillimit të tij, etj.⁶²
 - Gjyqtarja analizon dispozitat e Kodit të Familjes (nenin 132 e vijues të K.Familjes) në lidhje me institutin e martesës, parimet mbi të cilat mbështetet martesë, rastet e zgjidhjes së saj, shkaqet ligjore, pasojat e zgjidhjes së martesës për bashkëshortët dhe fëmijët e mitur, duke analizuar gjerësisht dispozitat e Kushtetës, të akteve ndërkombëtare dhe të K.Familjes në lidhje me parimin e interesit më të lartë të fëmijës.⁶³ Po ashtu, gjyqtarja interpreton dispozitat e Kodit të Familjes lidhur me përgjegjësinë prindërore, duke evidentuar kuptimin e këtij instituti dhe karakteristikat e tij.⁶⁴
 - Analizon kushtet dhe kriteret procedurale dhe ligjore në rastet e padive për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes dhe të verifikimit të urdhrit të mbrojtjes, duke interpretuar dispozitat e ligjit të posaçëm nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar, duke u ndaluar te subjektet, në raport me legjitimitimin e palëve, qëllimin e masave parandaluese, llojet e dhunës, përshtatshmërinë e masave mbrojtëse, etj.⁶⁵
 - Trajton dispozitat e ligjit të posaçëm “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, në raport me parashikimet e Kodit Civil për dhënien e kuptimit të termit “Kredi”, si dhe analizon

⁶¹ Vendimi nr. 720, datë 25.07.2017.

⁶² Vendimi nr. 267, datë 27.03.2018.

⁶³ Vendimi nr. 516, datë 12.06.2018, vendimi nr. 589, datë 03.07.2018, vendimi nr. 1084, datë 07.12.2017.

⁶⁴ Vendimi nr. 1180, datë 28.12.2017.

⁶⁵ Vendimi nr. 97, datë 03.08.2018 dhe vendimi për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes.

elementët e kontratës së huasë, për të konkluduar nëse ajo përbën titull ekzekutiv, në kuptim të nenit 510 të K.Pr.Civile.⁶⁶

Në vendimet penale gjyqtarja interpreton dispozitat materiale (nenet 283/2, 291, 279/2, 121/a/2, 134/1,197 të Kodit Penal) në funksion të cilësimit juridik të veprës penale dhe të përgjegjësisë së autorit në kryerjen e saj, duke bërë zbërthimin e normave të pjesës së posaçme të Kodit Penal, në funksion të analizës së elementëve të figurës së veprës penale për të cilën procedohet. Gjyqtarja interpreton në nivel teorik normën relevante të K. Penal, duke bërë një përshkrim të përgjithshëm në lidhje me elementët dallues të veprës penale, e në vijim, duke e përqsaur me faktet e provuara në gjykim, nxjerr konkluzionin në lidhje me cilësimin juridik të faktit penal dhe përgjegjësinë penale të autorit.⁶⁷

Përgjithësisht, dispozitat e Kodit Penal (*të pjesës së posaçme*) analizohen duke zbërthyer të katër elementët e figurës së veprës penale, duke u përqendruar më tepër në anën objektive dhe subjektive të saj, e në disa raste edhe tek qëllimi, kur ai përbën element të qenësishëm të anës subjektive të figurës së veprës penale.⁶⁸ Në ato raste kur dispozita e pjesës së posaçme të K.Penal në lidhje me veprën penale që i atribuohet të pandehurit është një dispozitë *blankete*, gjyqtarja zbaton edhe ligjet e veçanta ku të referon fakti penal.⁶⁹

Përpos interpretimit të dispozitave materiale penale të pjesës së posaçme në lidhje me kualifikimin ligjor të veprave penale përkatëse për të cilat akuzohen të pandehurit, në çdo rast gjyqtarja interpreton dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, në drejtim të elementëve dhe instituteve, si më poshtë:

- Në lidhje me qëllimin e dënimit penal, individualizimin e tij (*nenet 47, 48, 49, 50 të K.Penal*) në lidhje me kushtet dhe kriteret ligjore që merren në konsideratë në caktimin dhe individualizimin e dënimit (*objekti, vendi, koha, gjendja në të cilën është kryer vepra penale, rrethanat e kryerjes së saj, nëse është e përhapur në atë rreth ku është kryer*) dhe rrezikshmërinë e autorit (*gjendja sociale, profesioni, arsimimi, gjendja familjare, gjendja gjyqësore, shkalla e fajit*),⁷⁰ ndikimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese, duke analizuar në disa raste në mënyrë të posaçme ndikimin e rrethanave lehtësuese, referuar qëndrimit të Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 238, datë

⁶⁶ Vendimi nr. 232, datë 16.07.2018.

⁶⁷ Në të gjitha vendimet penale të themelit konstatohet analiza teorike e dispozitave penale në lidhje me cilësimin juridik të faktit penal, para aplikimit mbi faktet e çështjes.

⁶⁸ Vendimi nr. 235, datë 25.07.2018 në lidhje me veprën penale "Përndjekja".

⁶⁹ Konkretisht në vendimin 180, datë 18.04.2017, në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, në analizë të objektit dhe anës objektive të veprës penale, gjyqtarja referon në dispozitat e Kodit Rrugor ndërsa në vendimin nr. 311, datë 24.10.2019, në analizën e anës objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 279/2 i Kodit Penal gjyqtarja referon në dispozitat respektive të ligjit nr. 99/2013 "Për armët".

⁷⁰ Në të gjitha vendimet penale të themelit konstatohet analiza e dispozitave të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal në lidhje me kriteret e caktimit dhe individualizimit të dënimit.

12.05.2004, në lidhje me rrethanat lehtësuese që ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit.⁷¹

- Interpreton dispozitën materiale penale (*nenet 59 dhe 63 të K. Penal*), në lidhje me aplikimin e alternativave të dënimit, duke u ndalur kryesisht në qëllimin, funksionin dhe kushtet që duhet të përmbushen për të përfituar i pandehuri një dënim alternativ, siç është ai i parashikuar në nenin 59⁷² apo nenin 63⁷³ të Kodit Penal.
- Trajton gjerësisht institutin e bashkëpunimit duke interpretuar dispozitat përkatëse (*nenin 25 të Kodit Penal*), duke evidentuar kuptimin, elementët e tij, cilësinë e tij si rrethanë cilësuese e veprës penale, duke inkorporuar në interpretimin e tij edhe praktikën gjyqësore relevante, unifikuese ose jo.⁷⁴

Përsa i përket interpretimit të dispozitave procedurale civile dhe penale, gjyqtarja i jep rëndësinë e duhur interpretimit të normës, jo vetëm sa i përket aspekteve të themelit të çështjes, por edhe atyre procedurale, në rastet kur ngrihen çështje të procedurës, apo kur është vetë dispozita procedurale ajo që vjen në ndihmë të zgjidhjes së çështjes në themel, si p.sh çështjet e seancave paraprake,⁷⁵ në kërkesën penale për zëvendësimin e masës së sigurimit⁷⁶ apo në çështjet në të cilat është vendosur pushimi i gjykimit.⁷⁷ Konkretisht:

- Në vendimet e kategorisë së çështjeve seancë paraprake (*dërgim në gjyq apo edhe kërkesë për pushimin e procedimit penal*), gjyqtarja i kushton rëndësi interpretimit të normave procedurale penale (*nenet 329, 329/a, 329/b, 331, 332 e vijues të K.Pr.Penale*) në drejtim të përcaktimit të rolit të gjykatës në kontrollin dhe vlerësimin e veprimeve të kryera gjatë fazës së hetimit paraprak, analizës dhe vlerësimit në drejtim të qëllimit të këtij instituti të ri procedural (*seancës paraprake*), funksionin e kësaj faze procedurale, si dhe detyrat e gjyqtarit të seancës paraprake⁷⁸ në funksion të vlerësimit të plotësimin të kushteve dhe kriterëve ligjore për dërgimin e çështjes në gjyq, ose pushimin e procedimit penal.
- Në kërkesën penale, me objekt zëvendësim mase sigurimi, në funksion të përcaktimit nëse ekzistojnë kushtet dhe kriteret për revokimin ose zëvendësimin e masave të sigurimit, gjyqtarja bën interpretim teorik të dispozitës, duke dhënë kuptimin e saj, si dhe duke përcaktuar kushtet dhe kriteret ligjore për aplikimin e saj. Interpretimi në nivel teorik i dispozitës (*neni 260 i K.Pr.Penale*) mbështetet me referimin edhe të qëndrimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 7, datë 14.10.2011, për t'u aplikuar më pas mbi rrethanat konkrete të çështjes.⁷⁹
- Në çështjet penale të themelit gjyqtarja interpreton dispozitat procedurale në mbështetje të argumentimit të saj në lidhje me vlerësimin e kërkesës për procedim me gjykim të

⁷¹ Vendimi nr. 311, datë 24.10.2019 dhe vendimi nr. 180, datë 18.04.2017.

⁷² Vendimi nr. 311, datë 24.10.2019 dhe vendimi nr. 132, datë 13.03.2017.

⁷³ Vendimi nr. 180, datë 18.04.2017.

⁷⁴ Vendimi nr. 132, datë 13.03.2017.

⁷⁵ Vendimi nr. 438, datë 31.10.2019, vendimi nr.353, datë 27.09.2018 dhe vendimi nr. 4, datë 04.10.2017.

⁷⁶ Vendimi nr. 198, datë 27.07.2017.

⁷⁷ Vendimi nr. 396, datë 05.04.2018 dhe vendimi nr. 1070, datë 04.12.2017.

⁷⁸ Vendimi nr. 4, datë 04.10.2017, vendimi nr.438, datë 31.10.2019 dhe vendimi nr. 353, datë 27.09.2018.

⁷⁹ Vendimi nr. 198, datë 27.07.2017.

shkurtuar⁸⁰ (*neni 403, 406 i K.Pr.Penale*), në mbështetje të të cilit referon edhe praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë (*vendimin nr. 2, datë 29.01.2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë*) dhe praktikën e Gjykatës Kushtetuese (*vendimi nr. 4, datë 10.02.2012*); pjesëmarrjen dhe të drejtat e palës së dëmtuar në gjykim⁸¹ (*neni 58 i K.Pr.Penale*), etj.

- Në çështjet familjare (*zgjdhje martese, heqja e përgjegjësisë prindërore*) gjyqtarja interpreton dispozitat procedurale (*nenin 51 të K.Pr.Civile*) në drejtim të vlerësimit lidhur me kompetencën tokësore për shqyrtimin e çështjes,⁸² përcaktimin e qëllimit të zhvillimit të seancës së pajtimit (*nenet 134 të K.Familjes dhe 158/b të K.Pr.Civile*),⁸³ marrjen e mendimit të fëmijës së mitur në seancë, në rastet kur plotësohen kushtet ligjore,⁸⁴ (*neni 6 i K.Familjes*) si dhe përcaktimin e natyrës së vendimit në lidhje me caktimin e detyrimit për ushqim, si një vendim i ndryshueshëm.⁸⁵
- Në çështjet civile në të cilat gjykimi ka përfunduar për shkaqe procedurale, gjyqtarja analizon dispozitat përkatëse (*neni 201, 179, 299 të K.Pr.Civile*) në drejtim të përcaktimit të natyrës së institutit të heqjes dorë nga e drejta e padisë,⁸⁶ të heqjes dorë nga gjykimi apo të vlerësimit të rasteve të pushimit të gjykimit.⁸⁷
- Në çështjet civile të themelit, gjyqtarja interpreton nenet e K.Pr.Civile në mbështetje të argumenteve në lidhje me ndryshimin e ndërgjyqësisë (*neni 161/c*);⁸⁸ përcaktimin e të drejtës së padisë dhe elementëve të saj, duke iu referuar në mënyrë të posaçme padisë së njohjes (*nenet 32/a, 32/c*);⁸⁹ padisë për saktësimin e kufijve dhe përcaktimit të elementëve të saj,⁹⁰ si dhe mjeteve procedurale të mbrojtjes në fazën e ekzekutimit (*nenet 609 dhe 610*);⁹¹ përcaktimin e barrës së provës (*nenet 7, 8 dhe 12*), fuqinë provuese të akteve zyrtare (*neni 253*), konceptin e fillimit të provës me shkresë (*neni 233/b*), lejimin e provës me dëshmitarë (*neni 231*);⁹² vlerësimin lidhur me kompetencën lëndore dhe tokësore të gjykatës për shqyrtimin e çështjes, posaçërisht në padinë për shpërblimin e dëmit nga zgjidhja e marrëdhënies së punës (*neni 41 i K.Pr.Civile në lidhje me nenin 7 të ligjit nr.49/2012, "Për organizimin dhe funksionin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar*);⁹³ etj.

⁸⁰ Vendimi nr. 132, datë 13.03.2017, vendimi nr. 235, datë 25.07.2018, vendimi nr. 311, datë 24.10.2019 dhe vendimi nr. 180, datë 18.04.2017.

⁸¹ Vendimi nr. 235, datë 25.07.2018.

⁸² Vendimi nr. 598, datë 03.07.2018, vendimi nr. 1084, datë 07.12.2017 dhe vendimi nr. 516, datë 12.06.2018.

⁸³ Po aty.

⁸⁴ Vendimi nr. 516, datë 12.06.2018.

⁸⁵ Vendimi nr. 598, datë 03.07.2018, vendimi nr. 1084, datë 07.12.2017 dhe vendimi nr. 516, datë 12.06.2018.

⁸⁶ Vendimi nr. 296, datë 05.04.2018.

⁸⁷ Vendimi nr. 97, datë 03.08.2018 dhe vendimi nr. 1070, datë 04.12.2017.

⁸⁸ Vendimi nr. 720, datë 25.07.2017.

⁸⁹ Vendimi nr. 720, datë 25.07.2017, vendimi nr. 967, datë 10.11.2017.

⁹⁰ Vendimi nr. 967, datë 10.11.2017.

⁹¹ Vendimi nr. 316, datë 06.04.2017.

⁹² Vendimi nr. 367, datë 27.03.2018.

⁹³ Vendimi nr. 1237, datë 27.12.2019.

Në lidhje me aftësinë e gjyqtarës për të përdorur jurisprudencën relevante, rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përdorur gjerësisht jurisprudencën relevante (*vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e Kolegjit Civil dhe Penal të Gjykatës së Lartë, vendimet e Gjykatës Kushtetuese, vendimet e GJEDNJ*), në mbështetje të argumenteve të saj në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, kryesisht në rastet si më poshtë:

- Në vendimin civil me objekt *përmbushje detyrimi kontraktor*, gjyqtarja identifikon vendimin unifikues nr.3, datë 29.03.2012, në lidhje me objektin dhe shkakun ligjor të padisë, vendimin unifikues nr. 932, datë 22.06.2000, në lidhje me kontratën e huasë dhe kushtet ligjore të vlefshmërisë së saj. Po ashtu, në këtë vendim referohet qëndrimi i Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 1179, datë 26.09.2007, në lidhje me barrën e provës dhe në vendimin nr. 1029, datë 03.11.1999, në lidhje me konceptin e fillimit të provës me shkresë.⁹⁴
- Në vendimin civil me objekt *pavlefshmëri titulli ekzekutiv dhe kundërshtim veprimesh përmbartimore*, gjyqtarja identifikon vendimin nr. 2014, datë 06.05.2010, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, në lidhje me mjetin procedural të kundërshtimit të veprimeve përmbartimore.⁹⁵
- Në vendimin me objekt zgjidhje martese, gjyqtarja referon qëndrimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 374, datë 12.06.2014, në lidhje me parimin e interesit më të lartë të fëmijës.⁹⁶
- Në vendimin civil me objekt *shpërblim që rrjedh nga marrëdhëniet e punës*, gjyqtarja referon në vendimin e Gjykatës Kushtetuese me nr. 33, datë 12.09.2007, në lidhje me mënyrën dhe shkaqet e zgjidhjes së marrëdhënies së punës.⁹⁷

Në vendimet penale të themelit gjyqtarja referon në jurisprudencën relevante si më poshtë:

- vendimin e GJEDNJ “Seidoviç kundër Italisë”, në lidhje me njoftimin dhe pjesëmarrjen e të pandehurit në gjykim;⁹⁸
- vendimet e GJEDNJ në çështjet “Sramek kundër Austrisë”, “Le Compte, Van Peuven dhe De Meyere kundër Belgjikës” në lidhje me kompetencën e gjykatës dhe vendimin “Schiesser kundër Zvicrës” në lidhje me kontrollin gjyqësor për veprimet e organeve të hetimit, në çështjen që ka lidhje me caktimin dhe zbatimin e masave të sigurimit;⁹⁹
- vendimet e Gjykatës Kushtetuese me nr. 12, datë 18.05.2005, nr. 14, datë 17.04.2007 dhe nr.4, datë 10.02.2012, në lidhje me parimin e gjykatës së caktuar me ligj;¹⁰⁰
- vendimin unifikues nr. 2, datë 29.01.2003, në lidhje me procedimin me gjykim të shkurtuar dhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 4, datë 10.02.2012, në lidhje me po këtë institut;¹⁰¹
- vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 238, datë 12.05.2004, në lidhje me rrethanat lehtësuese që ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit;¹⁰²

⁹⁴ Vendimi nr. 316, datë 06.04.2017.

⁹⁵ Vendimi nr. 316, datë 06.04.2017.

⁹⁶ Vendimi nr. 516, datë 12.06.2018.

⁹⁷ Vendimi nr. 1237, datë 27.12.2019.

⁹⁸ Vendim nr. 180, datë 18.04.2017.

⁹⁹ Vendimi nr. 198, datë 27.07.2017.

¹⁰⁰ Vendimi nr. 311, datë 24.10.2019, vendimi nr. 180, datë 18.04.2017 dhe vendimi nr. 235, datë 25.07.2017.

¹⁰¹ Vendimi nr. 311, datë 24.10.2019, vendimi nr. 180, datë 18.04.2017 dhe vendimi nr. 235, datë 25.07.2017.

¹⁰² Vendimi nr. 311, datë 24.10.2019 dhe vendimi nr. 180, datë 18.04.2017.

- vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë nr. 4, datë 15.04.2011, në lidhje me institutin e bashkëpunimit.¹⁰³
- vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë nr. 1, datë 27.03.2008, në lidhje me përcaktimin e “dozës së vogël”, për efekt të përgjegjësisë penale për mbajtjen e lëndës narkotike;¹⁰⁴
- vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 28, datë 23.06.2011, në lidhje me zëvendësimin e masave të sigurimit personal;¹⁰⁵
- vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë nr. 7, datë 14.10.2011, në lidhje me gjykatën kompetente në aspektin lëndor dhe funksional në kërkesat për caktimin/zëvendësimin dhe shuarjen e masave të sigurimit;¹⁰⁶
- vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë nr. 1, datë 08.01.2009, në lidhje me dilijencën e prokurorit në përmbushjen e detyrave të tij, në këndvështrim të kontrollit gjyqësor gjatë fazës së hetimit paraprak sa i përket caktimit dhe zbatimit të masave të sigurimit personal.¹⁰⁷

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, nga tërësia e vendimeve burim vlerësimi, rezulton kujdesi i përhershëm i gjyqtarës që gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes të referohen dhe zbatohen parimet e përgjithshme të së drejtës, gjë që realizohet jo vetëm duke i përmendur ato shprehimisht, por edhe të nxjerra nga konteksti i arsytimit të vendimit. Gjyqtarja njeh, referon dhe zbaton parimet materiale dhe procedurale gjatë gjykimit, siç janë:

- *Parimin e prezumimit të pafajësisë* i sanksionuar në nenin 4 të K.Pr.Penale, në nenin 30 të Kushtetutës apo në nenin 6, paragrafi 2 të KEDNJ, dhe parimin procedural penal që ka lidhje të drejtpërdrejtë me përcaktimin e përgjegjësisë penale të autorit “*përtej çdo dyshimi të arsyeshëm*”;¹⁰⁸
- *Parimin e ligjshmërisë – nullum crimen, nulla poena sine culpa*, i referuar dhe po ashtu i nxjerrë nga konteksti i arsytimit dhe konkluzionit të arritur në të gjitha vendimet penale të themelit¹⁰⁹ dhe ato të seancës paraprake;¹¹⁰
- Parimet e përgjithshme në caktimin e dënimit, *si të barazisë para ligjit, të drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe të dënimit, të humanizmit, përshtatshmërisë së llojit dhe masës së dënimit (neni 47, 1/b dhe 1/c i K.Penal)*, të cilat referohen shprehimisht dhe analizohen më pas në raport me rrethanat konkrete të çështjes;¹¹¹
- Në interpretimin e normave procedurale penale të ndryshuara mbi gjyqtarin e seancës paraprake, gjyqtarja përmend dhe citon se këta elementë respektojnë *parimin e ligjshmërisë, parimin e ekonomisë gjyqësore*, të respektimit të parimit kushtetues të

¹⁰³ Vendimi nr. 132, datë 13.03.2017.

¹⁰⁴ Vendimi nr. 132, datë 13.03.2017.

¹⁰⁵ Vendim nr. 198, datë 27.07.2017.

¹⁰⁶ Vendimi nr. 198, datë 27.07.2017.

¹⁰⁷ Vendimi nr. 198, datë 27.07.2017.

¹⁰⁸ Vendimi nr. 180, datë 18.04.2017, vendimi nr. 311, datë 24.10.2019, vendimi nr. 235, datë 25.07.2018 dhe vendimi nr. 132, datë 13.03.2017.

¹⁰⁹ Po aty.

¹¹⁰ Vendimi nr. 4, datë 04.10.2017.

¹¹¹ Po aty.

hetimit dhe gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, të respektimit dhe garantimit të të drejtave të viktimës dhe të pandehurit në një proces penal;¹¹²

- *Parimin e procesit të rregullt ligjor (neni 6 i KEDNJ dhe neni 42 i Kushtetutës)* si dhe garantimin e respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, posaçërisht të të drejtës për liri dhe siguri¹¹³ (neni 5 i KEDNJ, nenet 15, 27 dhe 28 të Kushtetutës), që jo vetëm referohen drejtpërdrejt në vendime në lidhje me aspekte të procedimit, por rezultojnë edhe nga arsyetimi, duke iu referuar aspekteve procedurale të gjykimit që lidhen me njoftimin dhe pjesëmarrjen e subjekteve në proces, të drejtën e mbrojtjes, etj.;¹¹⁴
- *Parimin e interesit më të lartë moral dhe material të fëmijëve të mitur*, duke cituar për këtë qëllim nenet 2, 3 dhe 5 të K.Familjes, dispozita të Konventës së OKB “Mbi të drejtat e fëmijëve”, Deklaratën për të Drejtat e Fëmijës, Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut. Në lidhje me të drejtën e takimit, gjyqtarja mban në konsideratë edhe të drejtën për jetë familjare të sanksionuar në nenin 8/1 të KEDNJ;
- Në vendimet civile, gjyqtarja referon parimin e disponibilitetit të padisë në drejtim të vlerësimit të së drejtës së paditësit për të hequr dorë nga gjykimi, ose nga e drejta e padisë,¹¹⁵ parimin e procesit të rregullt ligjor nëpërmjet zhvillimit të një hetimi gjyqësor të plotë dhe të gjithanshëm (nenet 14 dhe 16 të K.Pr.Civile).¹¹⁶

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në funksion të vlerësimit të çështjeve me karakter procedural, apo në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen. Po ashtu, në shumicën e vendimeve burim vlerësimi rezulton kujdesi i shtuar i gjyqtarës për të identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ, si dhe kujdesi për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural, ashtu edhe atë thelbësor, parime të cilat integrohen në arsyetim dhe mbështesin argumentet e gjyqtarës lidhur me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës në treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

1.B Arsyetimi ligjor

1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

¹¹² Vendimi nr. 438, datë 31.10.2019.

¹¹³ Vendimi nr. 198, datë 27.07.2017.

¹¹⁴ Vendimi nr. 180, datë 18.04.2017, vendimi nr. 311, datë 24.10.2019, vendimi nr. 235, datë 25.07.2018, vendimi nr. 132, datë 13.03.2017 dhe vendimi nr. 198, datë 27.07.2017.

¹¹⁵ Vendimi nr. 967, datë 10.11.2017, vendimi nr. 296, datë 05.04.2018 dhe vendimi nr. 97, datë 03.08.2018.

¹¹⁶ Vendimi nr. 998, datë 15.11.2017.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjuha e përdorur nga gjyqtarja gjatë gjykimit, në aktet procedurale të dosjeve të analizuara, në komunikimin shkresor me të tretët dhe në vendimet gjyqësore, është e thjeshtë, e qartë dhe e kuptueshme, në mënyrë që vendimi të kuptohet jo vetëm nga njohësit e mirë të ligjit.

Në përdorimin e instituteve të së drejtës, parimeve apo të drejtave të pjesëmarrësve në proces, evidentohet përdorimi i termave/shprehjeve në gjuhën latine, përgjithësisht të etiketuara, pas termit/shprehjes përkatëse në gjuhën shqipe, duke i bërë të kuptueshëm për lexuesin. Po ashtu, në referimin e fjalëve me karakter teknik, kryesisht në referimin e konkluzioneve të akteve të ekspertimit,¹¹⁷ apo si pasojë e referimit në ligje të posaçëm me karakter specifik,¹¹⁸ përdorimi i termave teknikë është i kufizuar, i shoqëruar me shpjegimin e tij, ose rezulton i qartë nga konteksti i arsytimit.

Nuk evidentohet në asnjë rast përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyes apo denigrues. Në vendimet gjyqësore për çështjet familjare (*me objekt zgjidhje martese, heqje e përgjegjësisë prindërore, lëshim i urdhrit të mbrojtjes*), evidentohet kujdesi i gjyqtarës për zgjedhjen e gjuhës së përdorur, me qëllim shmangien e fjalëve apo shprehjeve, pavarësisht mënyrës së formulimit të tyre nga palët, duke patur në vëmendje respektimin e parimit të interesit më të lartë të fëmijës dhe respektimit të të drejtës për jetë private dhe familjare të subjekteve të procedimit.¹¹⁹ I njëjti kujdes evidentohet edhe në çështjet penale që lidhen me veprën penale të “Përndjekjes”, në të cilat, për shkak të natyrës së veprës, terminologjia e përdorur nga palët mbart ngarkesë emocionale që diktohet nga qëndrimi subjektiv dhe ngushtësisht personal i subjekteve në raport me perceptimin e faktit penal.¹²⁰

Në arsytimin e vendimeve evidentohet zbatimi i saktë i rregullave gramatikore, të sintaksës në ndërtimin e fjalive, duke i dhënë qartësi përshkrimit të faktit, rrethanave procedurale dhe fakteve të çështjes, apo shprehjes së mendimit juridik. Rezulton në të gjitha vendimet gjyqësore përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (*ë dhe ç*). Fjalitë ndërtohen drejt dhe janë të organizuara në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës, dhe paragrafët apo nënndarjet e arsytimit të vendimit, gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi, në lidhje me kuptimin e tyre apo të kontekstit në të cilin përdoren.

Gjyqtarja përdor fjali me gjatësi mesatare dhe shpesh herë të gjata, si pasojë e vazhdimësisë së mendimit juridik të shprehur, por kjo nuk krijon paqartësi, pasi në çdo rast rezulton se mendimi është shprehur në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, duke organizuar fjalitë, paragrafët dhe nënndarjet e arsytimit të vendimit, në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës.

¹¹⁷ Vendimi nr. 316, datë 06.04.2017.

¹¹⁸ Vendimi nr. 132, datë 13.03.2017, vendimi nr.311, datë 24.10.2019.

¹¹⁹ Vendimi nr. 1180, datë 28.12.2017, vendimi nr. 97, datë 03.08.2018, vendimi për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, vendimi nr.589, datë 03.07.2018, vendimi nr. 1084, datë 07.12.2017 dhe vendimi nr. 516, datë 12.06.2018.

¹²⁰ Vendimi nr. 235, datë 25.07.2018.

Vendimet në përgjithësi janë të organizuar në nëndarje, të identifikuara në shumicën e vendimeve me tituj, duke orientuar qartë për përmbajtjen e tyre, dhe brenda nëndarjeve, në paragrafë, të cilët lidhen me njëri-tjetrin përmes kronologjisë dhe vazhdimësisë së mendimit.

Në vendimet përfundimtare të vëzhguara, evidentohet se gjyqtarja pasqyron dhe merr në analizë elementët proceduralë, si: kompetenca, juridiksioni, të drejtat e palëve, njoftimi i tyre, trajtimin e kërkesave të palëve ndërgjyqëse gjatë procesit gjyqësor dhe vendimmarrjet respektive të gjykatës lidhur me to, pavarësisht se nga përmbajtja e vendimit, jo në çdo rast këta elementë kanë qenë të diskutueshëm nga palët apo rrethanat e çështjes. Në vendimet burim vlerësimi pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur pretendimet dhe prapësimet e palëve, të cilat merren në analizë nga gjyqtarja. Po kështu, në disa nga vendimet e analizuar evidentohet vendosja e plotë e tekstit të dispozitave ligjore të zbatueshme, por duke vijuar në pjesën e argumentimit ligjor të gjykatës, me analizën dhe zbërthimin e dispozitave të cituara. Prezenca e këtyre elementëve, në disa raste në mënyrë tepër të detajuar, gjithsesi i jep qartësi elementëve proceduralë të gjykimit ose vendimit, dhe nuk cenon koncizitetin e tij.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se :

Gjyqtarja ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar, në përmbajtje të së cilës i përmbahet, në prezantimin e fakteve me natyrë procedurale dhe fakteve thelbësore të çështjes, identifikimit të ligjit të zbatueshëm, por edhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura, të cilat vijnë gjithnjë si pasojë e procesit të arsytimit ligjor dhe argumentimit logjik. Gjyqtarja ka një metodologji të qartë të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit, duke ndarë pjesën përshkuese-arsyetuese në nëndarje, të identifikuara me tituj, duke orientuar qartë për përmbajtjen e secilës pjesë. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkuese-arsyetuese, si dhe dispozitivin.

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënat e regjistrimit, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data dhe ora e shqyrtimit, palët, objekti i shqyrtimit, si dhe kërkimet e subjekteve të pranishme në proces.

Pjesa përshkuese-arsyetuese është e ndarë në disa pjesë të listuara formalisht me tituj, si: procedura, faktet e çështjes, pretendimet e palëve, legjislacioni i zbatueshëm, vlerësimi dhe

analiza juridike e gjykatës, në të cilën në mënyrë të detajuar analizon: (i) elementët proceduralë të vlerësuar nga gjykata (juridiksioni, kompetenca, formimi i trupit gjykues), vlerësimi për kërkesat procedurale të palëve, së bashku me argumentet për vendimmarrjen respektive të gjykatës lidhur me to; (ii) faktet thelbësore të çështjes (fakti penal apo faktet e çështjes civile objekt shqyrtimi), të integruara me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim, (iii) pretendimet e palëve gjatë gjykimit, (iii) ligjin e zbatueshëm, duke u ndalur jo vetëm tek dispozitat materiale penale dhe civile, por edhe ato të ligjit të posaçëm, ku të referon fakti juridik civil apo penal për zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe (iv) vlerësimi i gjykatës, në të cilin merr në analizë ligjin e zbatueshëm, si dhe elementët e tij në përputhje me faktet konkrete, për të përfunduar me një përmbledhje dhe konkluzion mbi çështjen. Në disa prej vendimeve burim vlerësimi, diktuar nga kompleksiteti i tyre, pas arsytimit dhe konkluzioneve të gjykatës lidhur me zgjidhjen e çështjes, gjyqtarja paraqet në një pjesë të veçantë analizën dhe argumentimin lidhur me pretendimet e palëve.

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës dhe data e shpalljes së vendimit. Konstatohet gjithashtu se dispozitivi i vendimeve është i plotë dhe në të gjejnë pasqyrim jo vetëm disponimi i gjykatës mbi padinë e evokuar nga paditësi (*pranimin apo rrëzimin e kërkesë padisë*), apo në lidhje me përgjegjësinë penale të të pandehurit mbi akuzën që i atribuohet (*deklarimin fajtor por edhe deklarimin e pafajshëm*), apo mënyrën e disponimit në çështjet specifike të seancës paraprake (*për dërgimin e çështjes në gjyq ose pushimin e procedimit penal*), dënimin dhe masën e dënimit, por njëkohësisht edhe se kujt i ngarkohen shpenzimet gjyqësore. Gjithashtu, në të gjitha vendimet objekt vlerësimi pasqyrohet e drejta e ankimit dhe afati i ushtrimit të saj.

Konstatohet se vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural, elementët e parashikuar në: (i) nenin 310 të K.Pr.Civile, në vendimet civile dhe familjare, (ii) nenin 260 të K.Pr.Penale, në vendimin e kërkesës së hetimeve paraprake, (iii) nenin 332/e dhe 329.b të K.Pr.Penale, në vendimet seancë paraprake, (iv) nenin 383 të K.Pr.Penale, në vendimet penale. Po kështu, vendimet përgjithësisht janë të strukturuar në paragrafë dhe nënndarje, çka lehtëson kuptueshmërinë e arsytimit të gjykatës për çdo pretendim të ngritur, në funksion të vendimmarrjes përfundimtare.

Në tërësi, nga pikëpamja e përmbajtjes, mënyra e të shkruarit të vendimeve është e qartë dhe e strukturuar mirë, gjithmonë sipas këtij rendi: trajtimi i aspekteve procedurale të ngritura gjatë gjykimit, parashtrimi i rrethanave të faktit, pretendimet e të gjitha palëve ndërgjyqëse, ligji i zbatueshëm, trajtimi i çështjeve që duhet të shqyrtohen nga gjykata, të cilat në çështje komplekse janë shtruar në formën e pyetjeve të vlerësuara thelbësore për zgjidhjen e çështjes,¹²¹ duke përfshirë analizën e pretendimeve të palëve dhe në fund të pjesës arsytuese, përfundimet e arritura nga gjyqtarja. Në përgjithësi konstatohet që për çdo nënndarje apo njësi e vendimit të jenë vendosur titujt përkatës, për orientimin e duhur të palëve dhe gjykatave më të larta mbi përmbajtjen e vendimit.

¹²¹ Vendimi nr.167, datë 27.03.2018.

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit, ndjek rregullat e shkrimit dhe arsytimit ligjor dhe përdor një metodë të qartë në strukturimin e vendimit si në aspektin vizual, ashtu edhe në përmbajtje të tij.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës në treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit”, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se :

Në të gjitha vendimet burim vlerësimi, rezulton një nivel shumë i mirë arsytimi, gjithnjë i detajuar, i plotë dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të nevojshëm në raport me faktin civil apo penal, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t’u analizuar në raport me aspektet procedurale (*kryesisht çështje të kompetencës lëndore dhe tokësore, procedimit me gjykim të shkurtuar, ndryshimin e ndërgjyqësisë, ndërhyrjen kryesore, ndryshimin e objektit të padisë, etj.*).

Arsytimi i vendimeve përfundimtare ndjek një organizim funksional dhe zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material civil apo penal, duke integruar qartë faktet me provat e administruara dhe aplikimin e ligjit mbi faktet e çështjes konkrete, në shërbim të konkluzioneve të arritura për zgjidhjen e çështjes. Evidentohet kujdesi të tregon gjyqtarja në arsytim, për të identifikuar dhe analizuar institutet dhe konceptet ligjore, në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me natyrën e mosmarrëveshjes/çështjes dhe zgjidhjen e saj. Gjyqtarja evidenton në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme thelbin e konfliktit objekt gjykimi, duke orientuar analizën juridike dhe duke zhvilluar argumentimin logjik të saj, në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes, duke treguar kujdes të posaçëm për evidentimin dhe argumentimin e marrëdhënies shkak-pasojë, në përqasjen e ligjit me faktet konkrete. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe gjithëpërfshirës, duke i dhënë përgjigje të argumentuar të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve ndërgjyqëse.

Në çështjet civile gjyqtarja i kushton rëndësi analizës së instituteve të caktuara të së drejtës, kur kjo rezulton e nevojshme, p.sh: (i) Institutit të parashkrimit fitues, si një mënyrë origjinale e fitimit të pronësisë;¹²² (ii) Institutit juridik të shpërblimit, në rastet e zgjidhjes së marrëdhënies së punës, duke analizuar në mënyrë të posaçme elementët e kontratës së punës,

¹²² Vendimi nr. 720. Datë 25.07.2017.

formën e saj, procedurën dhe afatet e zgjidhjes së kontratës, shkaqet e justifikuara, pasojat që vijnë nga mosrespektimi i dispozitave ligjore nga ana e punëdhënësit, etj.;¹²³ (iii) Institutit juridiko-civil të detyrimit dhe dëmit kontraktor, e në mënyrë të veçantë të kontratës së huasë, duke analizuar elementë të formës së saj, faktin krijues dhe shues, lidhur me ekzistencën e kësaj marrëdhënieje, elementë të interpretimit të kontratës dhe vlerësimit të sjelljes së palëve kontraktore, analizë të cilën gjyqtarja e mbështet jo vetëm duke iu referuar fakteve dhe ligjit të zbatueshëm, por duke mbajtur në vëmendje edhe jurisprudencën e unifikuar të Gjykatës së Lartë;¹²⁴ (iv) Institutit të zgjidhjes së martesës dhe përcaktimit të përgjegjësisë prindërore, duke analizuar martesën, shkaqet e zgjidhjes së saj, pasojat e zgjidhjes së martesës për bashkëshortët dhe fëmijët e mitur, duke u ndalur në këtë drejtim në pasojat në lidhje me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore dhe ato me karakter material, analizë e cila mbështetet në çdo rast në parimin e interesit më të lartë të fëmijës;¹²⁵ (v) padisë së veçantë të saktësisimit të kufijve, duke analizuar dispozitën përkatëse (neni 157) të Kodit Civil që parashikon këtë lloj padie, zbërthimit të elementeve përbërës të saj, aplikimin mbi faktet e çështjes dhe konkluzionin e arritur lidhur me zgjidhjen e çështjes;¹²⁶ (vi) mjeteve të posaçme të mbrojtjes gjatë fazës së ekzekutimit, duke i analizuar dispozitat përkatëse që parashikojnë paditë specifike për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv dhe kundërshtimin e veprimeve përmbartimore, në tërësinë e tyre, si dhe duke referuar në mbështetje të argumenteve të saj edhe praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë lidhur me shkakun ligjor dhe objektin e padisë,¹²⁷ me qëllim përcaktimin e natyrës së mosmarrëveshjes, dhe praktikën e Gjykatës Kushtetuese¹²⁸ dhe praktikën e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë,¹²⁹ lidhur me këto mjete të posaçme procedurale.¹³⁰

Në vendimet penale burim vlerësimi, karakteristikë e gjyqtarës është veçimi dhe analiza e detajuar e fakteve esenciale të cilat kanë rezultuar të provuara në gjykim dhe marrja në analizë e tyre në drejtim të ekzistencës së elementëve të figurës së veprës penale për të cilën procedohet dhe autorësinë e saj, paraqitja e provave në lidhje me secilin fakt, duke lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë provën/provat përkatëse me aspektet ligjore konkrete të cilat ato mbështesin, si dhe elementin që sjell secila provë në shërbim të provueshmërisë së tij, duke evidentuar qartë dhe në mënyrë të natyrshme lidhjen shkak-pasojë mes veprimeve të të pandehurve, në raport me faktin penal të provuar. Gjithashtu, gjyqtarja është ndalur, kur ka qenë e nevojshme, në evidentimin dhe analizën e shkaqeve që kanë ndikuar në kryerjen e veprës penale, në përcaktimin e formës së kryerjes së veprës penale në rastet e procedimit për veprat penale në fushën e narkotikëve, përballjen e deklarimeve të dëshmitarëve apo bashkë-të-pandehurve gjatë hetimit apo gjykimit, me qëllim përcaktimin e vlerës provuese të këtyre

¹²³ Vendimi nr. 646, datë 23.10.2019.

¹²⁴ Vendimi nr. 267, datë 27.03.2018.

¹²⁵ Vendimi nr. 516, datë 12.06.2018, vendimi nr. 1084, datë 07.12.2017, vendimi nr.589, datë 03.07.2018 dhe vendimi nr. 1180, datë 28.12.2017.

¹²⁶ Vendimi nr. 998, datë 15.11.2017.

¹²⁷ Referohet vendimi unifikues nr. 3, datë 29.03.2012.

¹²⁸ Referohet vendimi nr. 39, datë 10.10.2007 i Gjykatës Kushtetuese.

¹²⁹ Referohet vendimi nr. 214, datë 06.05.2010 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

¹³⁰ Vendimi nr. 316, datë 06.04.2017.

deklarimeve, vlerësuar në raport me provat e tjera të marra në gjykim dhe individualizimin e rolit të secilit të pandehur, në rastin e veprave penale të kryera në bashkëpunim, etj.¹³¹

Në çdo rast, interpretimi dhe analiza e integruar e normave ligjore procedurale dhe materiale, në raport me faktet e provuara në gjykim, i shërben arsyetimit ligjor dhe zhvillimit të argumentimit logjik, për çdo fakt që lidhet me provueshmërinë e elementëve të veprave penale për të cilat procedohet, ecurisë procedurale të gjykimit, kushteve dhe kritereve ligjore të individualizimit të dënimit, kushteve dhe kritereve ligjore të aplikimit të masave të sigurimit personal, aplikimit të alternativave të dënimit me burgim, apo edhe disponimit mbi kërkesat e fazës së seancës paraprake.

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, ato janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor, duke u pozicionuar në atë pjesë të arsyetimit me të cilën lidhet pretendimi (*me aspektet procedurale të gjykimit, marrjen e provave dhe mënyrën e marrjes së tyre, provueshmërinë e faktit, cilësimin ligjor të faktit penal apo përcaktimin e natyrës së mosmarrëveshjes civile, etj*). Pretendimet e palëve gjithnjë janë marrë në shqyrtim dhe analizuar, në disa raste si pjesë e arsyetimit ligjor dhe në disa raste komplekse në një pjesë të veçuar të arsyetimit, por në pjesën përkatëse të arsyetimit që ka të bëjë pikërisht me pretendimin konkret, duke u dhënë një përgjigje të argumentuar dhe duke u analizuar, në aspektin e mbështetjes në ligj ose prova të tyre, duke u integruar në mënyrë të natyrshme si pjesë e arsyetimit tërësor.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik ndjek rregullin: fakt-normë-interpretim-konkluzion, duke krijuar një pamje të qartë të vetë zhvillimit të mendimit juridik të gjyqtares në mënyrën e organizimit dhe paraqitjes së procesit analitik dhe logjik të arsyetimit. Në secilin vendim të analizuar, mendimi logjik ka vijueshmëri dhe spikat interpretimi individual i ligjit, si dhe mbështetja e tij në qëndrimet e praktikës gjyqësore, duke pasuruar arsyetimin e vetë gjyqtares. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve apo çështjeve të shtruara për diskutim në aspektin procedural dhe thelbësor, në shërbim të zgjidhjes së çështjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

¹³¹ Vendimi nr. 132, datë 13.03.2017.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarës {...} në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A Aftësia e gjyqtarës për të përballuar ngarkesën në punë.

2.A.a Respektimi i afateve ligjore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore¹³² për periudhën e vlerësimit, rezultojnë se gjyqtarja ka gjykuar gjithsej 277 çështje për të cilat ligji parashikon afat ligjor shqyrtimi (183 çështje në vitin 2017, 64 çështje në vitin 2018 dhe 30 çështje në vitin 2019), të cilat i përkasin kategorisë së çështjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, “Familjare me palë kundërshtare”, “Kërkesa penale në fazën e hetimit paraprak” dhe “Penale seancë parapake”.

Sipas të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik, rezultojnë se nga 277 (dyqind e shtatëdhjetë e shtatë) çështje për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, 44 (dyzetë e katër)¹³³ prej tyre janë shqyrtuar në tejkalim të këtij afati. Referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (44 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (277 çështje), gjyqtarja rezultojnë që të ketë gjykuar 15.8% të çështjeve jashtë afatit ligjor.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja parashtron se gjatë vitit 2017 ka gjykuar me vendim përfundimtar 475 çështje, ndërmjet të cilave 67 kanë qenë penale themeli, 156 civile

¹³² Dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat në datën 24.02.2021, protokolluar në këshill me aktin nr. 5712/6 Prot., datë 24.02.2021.

¹³³ Në Tabelën nr. 1 çështja me numër rendor 68, në Tabelën nr. 2 çështjet me numër rendor 211, 219, 226, 230 dhe 248, në Tabelën nr. 3 çështjet me numër rendor 7, 18, 22 dhe 23, dhe në Tabelën nr. 10 çështja me numër rendor 11.

themeli, 107 kërkesa penale dhe 145 kërkesa civile. Gjatë vitit 2018 ka gjykuar 275 çështje, ndërmjet të cilave 35 kanë qenë penale themeli, 101 civile themeli, 80 kërkesa penale dhe 59 kërkesa civile. Ndërsa në vitin 2019 ka gjykuar 115 çështje nga 169 të regjistruara, ndërmjet të cilave 7 janë themeli penale, 14 civile themeli, 58 kërkesa penale, (10 kanë qenë masa sigurimi, 43 seanca paraprake dhe 5 kanë qenë kërkesa penale të ndryshme) si dhe 35 kërkesa civile. Gjithashtu, gjyqtarja parashtron se në muajin tetor të vitit 2018 ka qenë me raport për paaftësi të përkohshme në punë dhe me raport regjim shtrati dhe në nëntor ka marrë lejen e paralindjes, ndërsa deri në muajin tetor 2019 ka vijuar me leje lindje. Në muajin tetor 2019 ka filluar punë dhe në 1 nëntor 2019 deri në 30 nëntor 2019 ka marrë lejen vjetore të pashfrytëzuar, të miratuar nga Zv/Kryetari.

Analiza e të dhënave statistikore nga ana e vlerësuesit duhet bërë në mënyrë të tillë që të shmangen përfundimet që vijnë për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Për analizën e këtij treguesi, vlerësuesi nuk bazohet vetëm në të dhënat statistikore, por merr në konsideratë të gjitha të dhënat dhe burimet e tjera të vlerësimit. Duke iu referuar tabelave me të dhënat statistikore, për 44 çështjet e shqyrtuara jashtë afateve ligjore, rezulton se çështjet me objekt “Lëshim urdhër ekzekutimi”,¹³⁴ përbëjnë 20 çështje, të cilat respektivisht janë gjykuar për 11 ditë, 6 ditë, 12 ditë, 7 ditë, 9 ditë, 13 ditë, 8 ditë (*çështje të pasqyruar në tabelën nr.2, viti 2017*), në tejkallim të papërfillshëm të afatit 5 ditor të përcaktuar në nenin 510 të K.Pr.Civile.

Në çështjet me objekt “Dërgimin e çështjes në gjyq”, nga 46 çështje, 10 prej tyre janë gjykuar jashtë afatit ligjor 30 ditor, të përcaktuar në nenin 332/3 të K.Pr.Penale. Evidentohet se në disa raste vonesa në shqyrtim ka ardhur si pasojë e lejes vjetore të kryer gjatë muajt gusht, apo për shkak të kalimit të çështjes gjyqtares, pas largimit të gjyqtarit të caktuar më parë për shqyrtimin e saj. Konkretisht, çështja me numër rendor 38 (*Tabela 11, viti 2018*), është regjistruar në datën 26.07.2018 dhe ka përfunduar në datën 17.09.2018. Nëse në përllogaritjen e afatit të gjykimit nuk do të përfshihej periudha që gjyqtarja ka qenë me leje vjetore (*muaj gusht*), atëherë kjo çështje do të kishte përfunduar për 18 ditë, pra brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 332/3 të K.Pr.Penale. Çështja me numër rendor 1 (*Tabela 11, viti 2019*), është regjistruar në datën 25.07.2019, por gjyqtares i ka kaluar me short në datën 24.10.2019 (*pas rishortimit të çështjes për shkak të largimit të gjyqtarit paraardhës*) dhe ka përfunduar në datën 27.12.2019. Nëse përllogaritja e afatit të gjykimit do të fillonte nga data e caktimit të çështjes me short gjyqtares {...}, si dhe nuk do të përfshihej periudha që gjyqtarja ka qenë me leje vjetore (*01.11.2019-27.11.2019*), atëherë kjo çështje do të kishte përfunduar për 37 ditë (*tejkallim i papërfillshëm 7 ditë mbi afatin ligjor*). Po, kështu në çështjen me numër rendor 2 (*Tabela 11, viti 2019*), e cila është regjistruar në datën 31.07.2019, por gjyqtares i ka kaluar me short në datën 24.10.2019 (*pas rishortimit të çështjes për shkak të largimit të gjyqtarit paraardhës*) dhe ka përfunduar në datën 30.10.2019. Nëse përllogaritja e afatit të gjykimit do të fillonte nga data e caktimit të çështjes me short

¹³⁴ Kërkesat e regjistruara para datës 07.11.2017, datë në të cilën ka hyrë në fuqi ligji nr. 38/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8116, datë 29.03.1996, Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”.

gjqtares {...}, atëherë kjo çështje do të kishte përfunduar për 6 ditë, pra brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 332/3 të K.Pr.Penale.

Nëse në përlllogaritjen e çështjeve të shqyrtuar jashtë afatit ligjor, do të përjashtoheshin çështjet ku afati ligjor është tejkaluar me një kohë relativisht të shkurtër (1, ditë, 2 ditë, 3 ditë, 6 ditë dhe 7 ditë), si dhe çështjet të cilat i kanë kaluar gjyqtarës me short pas rishortimit të tyre, atëherë do të rezultonte se raporti i çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (21 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (277 çështje), gjyqtarja rezulton që të ketë gjykuar **7.58% të çështjeve jashtë afatit ligjor**.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “0-10 %”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka gjykuar gjithsej 511¹³⁵ çështje (237 çështje në vitin 2017, 194 çështje në vitin 2018 dhe 80 çështje në vitin 2019), të cilat i përkasin kategorisë së çështjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, “Familjare me palë kundërshtare”, “Familjare pa palë kundërshtare”, “Marrëdhënie pune”, “Penale krime”, “Penale kundravajtje”, “Seanca paraprake-kërkesa për pushimin e procedimit penal” dhe “Kërkesa penale në fazën e ekzekutimit”, për të cilat vendimi nr. 261/2, datë 14.04.2010, i KLD përcakton këto standarde minimale kohore për gjykimin në gjykatën e shkallës së parë:

- jo më tej se 6 muaj për gjykimet civile;
- jo më tej se 4 muaj për gjykimet familjare;
- jo më tej se 9 muaj për krimet me maksimumin e dënimit deri në 10 vjet dhe 12 muaj për krimet me minimumin e dënimit jo më pak se 10 vjet;
- jo më tej se 4 muaj për kundërvajtjet;
- jo më tej se 2 muaj për gjykimin e kërkesave civile pa palë kundërshtare;
- jo më tej se 2 muaj për gjykimin e kërkesave administrativo-penale.

Sipas të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se nga 511 çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, 135 prej tyre ose **26.4% janë gjykuar jashtë standardit** minimal kohor në fuqi.

¹³⁵ Pa përfshirë këtu çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi.

Gjyqtarja në Formularin e Integruar të Vlerësimit dhe të pasqyruara në raportin analitik, ka bërë prezent një sërë shkaqesh të cilat kanë ndikuar në kohëzgjatjen e shqyrtimit të çështjeve të cilat lidhen me rrethanat objektive në funksion të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor. Gjyqtarja në mënyrë të detajuar ka shpjeguar shkaqet e mbarimit tej afateve orientuese standard minimal kohor për disa prej tyre, duke vlerësuar në mënyrë të përmbledhur si shkaqe objektive, problematikat që kanë të bëjnë me vështirësitë e njoftimit të rregullt të palëve për shkak të adresave jo të sakta dhe kryerjen jo të rregullt të njoftimit nga ana e shërbimit postar. Po kështu, për disa çështje penale ose civile gjykimi ka filluar nga e para, për shkak të ndryshimit të gjyqtarit relator të çështjes, dhe kjo ka shkaktuar zgjatje të afateve të përcaktuara në standardet minimale kohore.

Duke iu referuar tabelave me të dhënat statistikore, për 135 çështjet e shqyrtuara jashtë standardit minimal kohor, rezulton se në disa raste vonesa në shqyrtim ka ardhur si pasojë e lejes vjetore të kryer nga gjyqtarja (*muaj gusht i vitit 2017, vitit 2018, si dhe 01-27 nëntor 2019*). Nëse në përlllogaritjen e afatit të gjykimit nuk do të përfshihej periudha kur gjyqtarja ka qenë me leje vjetore, atëherë disa prej këtyre çështjeve do të kishin përfunduar brenda standardeve minimale kohor. Konkretisht:

- çështja me numër rendor 34 (*Tabela 1, viti 2017*), i është caktuar gjyqtares me short në datën 28.03.2017 dhe ka përfunduar në datën 16.10.2017, duke hequr periudhën e lejes vjetore, kjo çështje do të kishte përfunduar për 171 ditë, pra brenda standardit minimal kohor për gjykimin e çështjeve civile me palë kundërshtare;
- çështja me numër rendor 37 (*Tabela 1, viti 2017*), i është caktuar gjyqtares me short në datën 28.04.2017 dhe ka përfunduar në datën 10.11.2017, duke hequr periudhën e lejes vjetore, kjo çështje do të kishte përfunduar për 166 ditë, pra brenda standardit minimal kohor për gjykimin e çështjeve civile me palë kundërshtare;
- çështja me numër rendor 150 (*Tabela 2, viti 2017*), i është caktuar gjyqtares me short në datën në datën 30.06.2017 dhe ka përfunduar në datën 14.09.2017, duke hequr periudhën e lejes vjetore, kjo çështje do të kishte përfunduar për 45 ditë, pra brenda standardit minimal kohor për gjykimin e kërkesave civile pa palë kundërshtare;
- çështja me numër rendor 13 (*Tabela 9, viti 2017*), i është caktuar gjyqtares me short në datën në datën 20.04.2017 dhe ka përfunduar në datën 13.09.2017, duke hequr periudhën e lejes vjetore, kjo çështje do të kishte përfunduar për 115 ditë, pra brenda standardit minimal kohor për gjykimin e çështjeve penale - kundravajtje;
- çështja me numër rendor 22 (*Tabela 9, viti 2017*), i është caktuar gjyqtares me short në datën në datën 23.05.2017 dhe ka përfunduar në datën 04.10.2017, duke hequr periudhën e lejes vjetore, kjo çështje do të kishte përfunduar për 103 ditë, pra brenda standardit minimal kohor për gjykimin e çështjeve penale - kundravajtje;
- çështja me numër rendor 1 (*Tabela 1, viti 2018*), i është caktuar gjyqtares me short në datën 16.06.2017 dhe ka përfunduar në datën 15.01.2018, duke hequr periudhën e lejes vjetore, kjo çështje do të kishte përfunduar për 179 ditë, pra brenda standardit minimal kohor për gjykimin e çështjeve civile me palë kundërshtare;
- çështja me numër rendor 41 (*Tabela 1, viti 2018*), i është caktuar gjyqtares me short në datën 01.03.2018 dhe ka përfunduar në datën 18.09.2018, duke hequr periudhën e lejes vjetore,

- kjo çështje do të kishte përfunduar për 170 ditë, pra brenda standardit minimal kohor për gjykimin e çështjeve civile me palë kundërshtare;
- çështja me numër rendor 20 (*Tabela 2, viti 2018*), i është caktuar gjyqtarës me short në datën në datën 02.07.2018 dhe ka përfunduar në datën 18.09.2017, duke hequr periudhën e lejes vjetore, kjo çështje do të kishte përfunduar për 47 ditë, pra brenda standardit minimal kohor për gjykimin e kërkesave civile pa palë kundërshtare;
 - çështja me numër rendor 28 (*Tabela 3, viti 2018*), i është caktuar gjyqtarës me short në datën 07.05.2018 dhe ka përfunduar në datën 25.09.2018, duke hequr periudhën e lejes vjetore, kjo çështje do të kishte përfunduar për 110 ditë, pra brenda standardit minimal kohor për gjykimin e çështjeve familjare;
 - çështja me numër rendor 30 (*Tabela 11, viti 2018*), i është caktuar gjyqtarës me short në datën 19.06.2018 dhe ka përfunduar në datën 11.09.2018, duke hequr periudhën e lejes vjetore, kjo çështje do të kishte përfunduar për 53 ditë, pra brenda standardit minimal kohor për gjykimin e kërkesave administrativo-penale;
 - çështja me numër rendor 8 (*Tabela 11, viti 2018*), i është caktuar gjyqtarës me short në datën 26.06.2018 dhe ka përfunduar në datën 25.09.2018, duke hequr periudhën e lejes vjetore, kjo çështje do të kishte përfunduar për 60 ditë, pra brenda standardit minimal kohor për gjykimin e kërkesave administrativo-penale;
 - çështja me numër rendor 9 (*Tabela 11, viti 2018*), i është caktuar gjyqtarës me short në datën 16.07.2018 dhe ka përfunduar në datën 25.09.2018, duke hequr periudhën e lejes vjetore, kjo çështje do të kishte përfunduar për 40 ditë, pra brenda standardit minimal kohor për gjykimin e kërkesave administrativo-penale;
 - çështjen me numër rendor 2 (*Tabela 7, viti 2019*), është regjistruar në datën 24.05.2019, por gjyqtarës i ka kaluar me short në datën 24.10.2019 (*pas rishortimit të çështjes për shkak të largimit të gjyqtarit paraardhës*) dhe ka përfunduar në datën 27.12.2019, duke përfunduar për 64 ditë, duke hequr këtu edhe periudhën e lejes (1-27 nëntor), kjo çështje do të kishte përfunduar për 37 ditë, pra brenda standardit minimal kohor për gjykimin e çështjeve civile me palë kundërshtare;
 - çështja me numër rendor 2 (*Tabela 12, viti 2019*), i është caktuar gjyqtarës me short në datën 10.10.2019 dhe ka përfunduar në datën 24.12.2019, duke hequr periudhën e lejes (1-27 nëntor), kjo çështje do të kishte përfunduar për 48 ditë, pra brenda standardit minimal kohor për gjykimin e kërkesave administrativo-penale.

Nëse në përlogaritjen e çështjeve të shqyrtuara jashtë standardit minimal kohor, do të përjashtoheshin çështjet e analizuara më sipër, atëherë do të rezultonte se nga 511 çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, 115 prej tyre ose **22.5% janë gjykuar jashtë standardit** minimal kohor në fuqi.

Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, numrit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të standardit minimal kohor, në raport me numrin total të çështjeve të gjykuara, kohës relativisht të shkurtër të tejkalimit të standardit minimal kohor në shumicën e çështjeve të analizuara (*tejkalime nga 3 ditë deri në 17 ditë*) sipas të dhënave statistikore, për këtë tregues gjyqtarja pikëzohet me një nivel më të lartë pikëzimi sesa ai që i përket përqindjes së çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit, pra, në nivelin 11-20%, duke e pikëzuar me 4 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtares për këtë tregues vlerësohet në nivelin “11-20%”, duke e pikëzuar me 4 pikë.

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, krahasuar me standardin minimal kohor në fuqi sipas vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010, të KLD, për secilën kategori, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, është më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar për shumicën e kategorive të çështjeve. Konkretisht,

- i. Në kategorinë e çështjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është 271 ditë (9 muaj), pra më e gjatë se standardi minimal kohor i miratuar, prej gjashtë muaj. Edhe nëse në analizën e kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje për këtë kategori nuk do të përfshihej kohëzgjatja e çështjeve të analizuara në treguesin e mësipërm, prapëseprapë, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje do të rezultonte 249 ditë (8.3 muaj), pra më e gjatë se standardi minimal kohor i miratuar, prej 6 muaj;
- ii. Në kategorinë e çështjeve “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është 41 ditë (1 muaj e 11 ditë), pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj;
- iii. Në kategorinë e çështjeve “Familjare me palë kundërshtare”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është 110 ditë (3 muaj e 20 ditë), pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar, prej 4 muaj;
- iv. Në kategorinë e çështjeve “Familjare pa palë kundërshtare”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është 80 ditë (2 muaj e 20 ditë), pra më e gjatë se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj;
- v. Në kategorinë e çështjeve “Marrëdhënie pune”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është 143 ditë (4 muaj e 23 ditë), pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar, prej 6 muaj;
- vi. Në kategorinë e çështjeve “Penale-krime”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, është 87 ditë (2 muaj e 27 ditë), pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar, prej 9 apo 12 muaj;
- vii. Në kategorinë e çështjeve “Penale-kundërvajtje”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është 87 ditë (2 muaj e 27 ditë), pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar, prej 4 muaj;
- viii. Në kategorinë e çështjeve “Kërkesa penale në fazën e hetimit paraprak”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është 60 ditë (2 muaj), pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj;

- ix. Në kategorinë e çështjeve “Seancë paraprake-kërkesë për pushimin e procedimit penal”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është 25 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj;
- x. Në kategorinë e çështjeve “Kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është 42 ditë (1 muaj e 12 ditë), pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja dhe kryetari e kanë vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë, duke renditur si shkak që ka ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimeve natyrën e çështjeve, vështirësitë me natyrë procedurale, të cilat ndikojnë objektivisht në ecurinë normale të një gjykimi.

Në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se për të bërë pikëzimin e këtij treguesi, të dhënat statistikore analizohen sipas situatës për të shmangur përfundimet që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit.¹³⁶ Referuar metodologjisë, duke qenë se nga 10 kategori çështjesh, vetëm për dy prej tyre koha mesatare tejkalon standardin minimal kohor, gjyqtari duhej të pikëzohej me 4 pikë. Por vlerësuesi merr parasysh në pikëzim situatën konkrete, duke shmangur çështjet që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Nga analiza e të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është **më e gjatë** se standardi minimal kohor i miratuar prej për vetëm 2 nga 10 kategoritë e çështjeve, duke u tejkualuar koha mesatare përkatësisht 2.3 muaj për kategorinë “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare” dhe 20 ditë për kategorinë “Familjare pa palë kundërshtare”.

Në tërësi, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga analiza e integruar burimeve të vlerësimit, si dhe krahasimit të kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje për të gjitha kategoritë, me standardin minimal kohor në fuqi për kategori çështjesh, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është dukshëm më e shkurtër se ky afat për 8 nga 10 kategoritë e çështjeve. Koha mesatare është më e gjatë se standardi vetëm për dy nga kategoritë e çështjeve, duke u tejkualuar ky afat me 2.3 muaj dhe 20 ditë, respektivisht. Për këto arsye, për këtë tregues gjyqtarja pikëzohet me një nivel më të lartë, duke e pikëzuar me 5 pikë.

¹³⁶ Metodologjia e Pikëzimit për këtë tregues parashikon se :“... Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzimin maksimal.”.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje konsiderohet më e shkurtër ose e barabartë me standardin minimal kohor për të gjitha kategoritë e çështjeve, duke e pikëzuar me 5 pikë.

2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve, për të gjithë periudhën e vlerësimit (01.01.2017-31.12.2019) si raport midis numrit të çështjeve të përfunduara (789 çështje), me numrin e çështjeve të caktuara (953 çështje) brenda vitit kalendarik, **është 82.79%.**

Duke konsideruar faktin që në vitin 2019¹³⁷ gjyqtarja ka ushtruar detyrën për vetëm 2 muaj, treguesit statistikorë për këtë periudhë nuk mund të japin të dhëna të sakta për treguesin e rendimentit, duke qenë se gjyqtarja ka filluar punë në fund të vitit (*në muajin tetor*) dhe gjatë muajit nëntor ka kryer lejen vjetore të pamarrë për 27 ditë. Për rrjedhojë, çështjet e caktuara nuk mund të përfundonin për një periudhë kohore të barabartë me 2 muaj, kohë kjo e barabartë ose më e shkurtër se standardi minimal kohor për shumicën e kategorive të çështjeve. Rrjedhimisht, treguesit e vitit 2019, nuk mund të merren në konsideratë në përlllogaritjen e rendimentit të përfundimit të çështjeve dhe kjo përlllogaritje do të bëhet mbi të dhënat statistikore të viteve të plota të ushtrimit të detyrës, përkatësisht viteve 2017 dhe 2018. Duke iu referuar numrit të çështjeve të përfunduara, me ato të caktuara për secilin vit, rezulton se:

Për vitin 2017 rendimenti i përfundimit të çështjeve është 86,2%;

Për vitin 2018 rendimenti i përfundimit të çështjeve është 93,5%;

Për të dy vitet së bashku, rendimenti mesatar i përfundimit të çështjeve është 92.1%.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja dhe kryetari e kanë vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë, duke renditur si shkak që ka ndikuar në likuidimin e çështjeve, problematikat që shfaqin çështjet civile, duke qenë proces kontradiktor, procedurën që ndiqet në zhvillimin e gjykimit, apo dhe afatin ligjor të gjykimit. Kjo vetëm për çështjet civile, pasi çështje penale karakterizohen nga një rrjedhshmëri e procesit gjyqësor, ndryshe nga ato civile.

Nga ana tjetër, duke iu referuar edhe ngarkesës së punës për periudhën e vlerësimit, si dhe faktit që për vitin 2018 gjyqtarja në fillim të muajit tetor është larguar me leje lindjeje, duke

¹³⁷ Duke iu referuar informacionit të dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me shkresën nr. 1754 Prot., datë 14.12.2020, rezulton se gjyqtarja {...} për periudhën 02.10.2018-02.10.2019 ka qenë larguar me leje lindje, fakt ky që ka ndikuar në përlllogaritjen matematikore të rendimentit të përfundimit të çështjeve gjyqësore.

mos arritur të përfundojë çështjet e caktuara, për këtë tregues gjyqtarja pikëzohet në një nivel më të lartë pikëzimi se ai që i takon përqindjes prej 92.1%, duke e pikëzuar me 8 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues pikëzohet me një nivel më të lartë pikëzimi se ai që përkon me rendimentin në masën 92.1%, duke e pikëzuar me 8 pikë.

2.A.d Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se koha mesatare e arsytimit të vendimeve gjyqësore për kategori të veçanta çështjesh është si më poshtë:

1. Për çështje të kategorisë “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, koha mesatare e arsytimit është 31.5 ditë, pra **më e gjatë se afati procedural** 20 ditë, i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile, duke u tejkaluar ky afat me 11.5 ditë;
2. Për çështje të kategorisë “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, koha mesatare e arsytimit është 12 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 20 ditë, i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile;
3. Për çështje të kategorisë “Familjare me palë kundërshtare”, koha mesatare e arsytimit është 13 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 20 ditë, i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile;
4. Për çështje të kategorisë “Familjare pa palë kundërshtare”, koha mesatare e arsytimit është 18 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 20 ditë, i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile;
5. Për çështje të kategorisë “Marrëdhënie pune”, koha mesatare e arsytimit është 42 ditë, pra **më e gjatë se afati procedural** 20 ditë, i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile, duke u tejkaluar ky afat me 22 ditë;
6. Për çështje të kategorisë “Penale-krime”, koha mesatare e arsytimit është 15 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 30 ditë, i parashikuar nga neni 382 i K.Pr.Penale;
7. Për çështje të kategorisë “Penale-kundravajtje”, koha mesatare e arsytimit është 20 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 30 ditë, i parashikuar nga neni 382 i K.Pr.Penale;
8. Për çështje të kategorisë “Kërkesa penale në fazën e hetimit paraprak”, koha mesatare e arsytimit është:
 - a. kërkesa me objekt “Vleftësim arresti/ndalimi dhe caktim mase sigurimi”, 8 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 5 ditë i parashikuar për efekt të së drejtës së ankimit, referuar nenit 249 të K.Pr.Penale, duke u tejkaluar ky afat vetëm me 3 ditë, tejkalim i cili vlerësohet të jetë i papërfillshëm, duke konsideruar edhe ditët e pushimit javor, të cilat ndikojnë në përlllogaritjen e afatit;
 - b. kërkesa me objekt “Verifikim i kushteve të zbatimit të masës së sigurimit”, 15 ditë, pra **më e gjatë se afati procedural** 48 orë i parashikuar nga neni 248 pika 2 i

K.Pr.Penale, duke u tejkualuar ky afat me 13 ditë;

- c. kërkesa me objekt “Zëvendësim/revokim mase sigurimi”, 5.4 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 5 ditë i parashikuar për efekt të së drejtës së ankimit, referuar nenit 249 i K.Pr.Penale. Në kushtet kur tejkalimi i afatit 5 ditor rezulton të jetë vetëm 0.4 ditë, pra nuk përbën 1 ditë të plotë, koha mesatare e arsytimit të vendimit për këtë kategori çështjesh do të vlerësohet e barabartë me afatin procedural;
- d. kërkesa me objekt “Shuarje mase sigurimi”, 4 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 48 orë i parashikuar nga neni 261/3 dhe 248/2 i K.Pr.Penale, duke u tejkualuar ky afat vetëm me 2 ditë, tejkalim i cili vlerësohet të jetë i papërfillshëm, duke konsideruar edhe ditët e pushimit javor, të cilat ndikojnë në përlllogaritjen e afatit;
- e. kërkesa me objekt “Lejim përgjimi/zgjatje afat përgjimi”, 2 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 24 orë i parashikuar nga neni 222/1 i K.Pr.Penale, duke u tejkualuar ky afat me 1 ditë. Në kushtet kur tejkalimi i afatit rezulton të jetë vetëm 1 ditë, ku përfshihen edhe ditët e shtunë e të diel, koha mesatare e arsytimit të vendimit për këtë kategori çështjesh do të vlerësohet e barabartë me afatin procedural;
- f. kërkesa për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsytimin e vendimit, 11 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural i përgjithshëm 30 ditë i parashikuar nga neni 382/3 i K.Pr.Penale;

9. Për çështje të kategorisë “Seancë paraprake”, koha mesatare e arsytimit është:

- a. çështjet me objekt “Dërgimin e çështjes në gjyq”, 11 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 10 ditë i parashikuar nga neni 332/dh i K.Pr.Penale, duke u tejkualuar ky afat vetëm me 1 ditë, tejkalim i cili vlerësohet të jetë i papërfillshëm, duke konsideruar edhe ditët e pushimit javor, të cilat ndikojnë në përlllogaritjen e afatit;
- b. çështje për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsytimin e vendimit, 19 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382/3 i K.Pr.Penale.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja dhe kryetari e kanë vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë, duke renditur si shkaqe që kanë ndikuar në kohën e arsytimit të vendimit: kompleksitetin e çështjeve, ngarkesën e punës, si dhe procesin administrativ të dorëzimit të dosjes efektivisht në sekretari, mund të ketë qenë jashtë këtij afati për shkak të ngarkesës së sekretares gjyqësore, edhe pse ky proces ka qenë në mbikëqyrjen e gjyqtares.

Sipas Metodologjisë, për të pikëzuar këtë tregues, analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, duke zbatuar një koeficient jo më shumë se 20%.

Referuar metodologjisë, duke qenë se nga 9 (nëntë) kategori çështjesh, vetëm për 3 (tre) prej tyre koha mesatare e arsytimit të vendimit tejkalon afatin procedural, konkretisht me 11.5; 22 dhe 13 ditë, si dhe duke patur parasysh kompleksitetin e çështjeve, ngarkesën e

punës të përballuar nga gjyqtarja për periudhën e vlerësimit, për këtë tregues gjyqtarja pikëzohet me një nivel më të lartë pikëzimi se ai që i përket kategorisë së kohës mesatare.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues vlerësohet “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.

2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh, duke përjashtuar ato pa palë kundërshtare, rezulton si më poshtë:

- i. për kategorinë “*Civile të përgjithshme me palë kundërshtare*” është 10 seanca;
- ii. për kategorinë “*Familjare me palë kundërshtare*” është 4 seanca;
- iii. për kategorinë “*Marrëdhënie pune*” është 4 seanca;
- iv. për kategorinë “*Krime*” është 8 seanca;
- v. për kategorinë “*Kundravajtje*” është 5 seanca.

Ndërkohë që për çështjet e kategorisë “Seancë paraprake” në tabelën e të dhënave statistikore, nuk ka të dhëna lidhur me numrin e seancave gjyqësore. Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, *treguesi i numrit të seancave për çështje bëhet pjesë e vlerësimit etik dhe profesional kur statistikat mundësohen në rrugë elektronike. Nëse kjo nuk është e mundur, ky tregues për vlerësimin dhe zvarritjen e gjykimeve, identifikohet dhe vlerësohet vetëm për çështjet e zgjedhura me short. Në mungesë të kësaj të dhëne për këtë kategori çështjesh, referohemi bëhet ndaj 3 (tre)¹³⁸ çështjeve të përzgjedhura me short, që i përkasin kategorisë së çështjeve “Seancë paraprake”. Rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore për kategorinë “Seancë paraprake” është 1 seancë.*

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se numri mesatar i seancave gjyqësore është **5.3 seanca gjyqësore**.

Nga vëzhgimi i dosjeve të çështjeve të përzgjedhura me short evidentohet se gjyqtarja ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që u drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët dhe në çdo

¹³⁸ Çështja me nr. 4 vendimi, datë 04.10.2017 me objekt “Kërkesë për pushimin e procedimit penal”, çështja me nr. 353 vendimi, datë 27.09.2018 me objekt “Dërgimin e çështjes në gjyq” dhe çështja me nr. 438 vendimi, datë 31.10.2019 me objekt “Dërgimin e çështjes në gjyq”.

rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë. Konstatohet nga aktet në dosjet burim vlerësimi se gjyqtarja për çdo çështje ka disponuar me urdhër për caktimin e datës së shqyrtimit të çështjes (*urdhër kalim në seancë gjyqësore pas ezaurimit të veprimeve përgatitore*), duke caktuar seancën e parë gjyqësore dhe duke pasqyruar në këtë akt urdhërimin e sekretarisë gjyqësore për kryerjen e njoftimeve të palëve ndërgjyqëse, sipas kritereve të parashikuara në K.Pr.Civile.

Në 14 (katërbëdhjetë)¹³⁹ nga 16 (gjashtëmbëdhjetë) çështjet e përzgjedhura me short, rezulton se: janë zhvilluar 8 (tetë) seanca gjyqësore për përfundimin e çështjes civile me palë kundërshtare me objekt “Njohje marrëdhënie pune”, 10 (dhjetë) seanca gjyqësore për përfundimin e çështjes civile me objekt “Saktësim kufijsh”, 6 (gjashtë) seanca gjyqësore për përfundimin e çështjes me objekt “Heqje e përgjegjësisë prindërore”, 3 (tre) seanca gjyqësore për përfundimin e çështjes penale të zhvilluar sipas ritit të gjykimit të shkurtuar, 9 (nëntë) seanca gjyqësore për zgjidhjen e martesës, 9 (nëntë) seanca gjyqësore për përfundimin e çështjes civile me objekt “Shpërblim dëmi”, 2 (dy) seanca gjyqësore për zgjidhjen e martesës, 3 (tre) seanca gjyqësore për përfundimin e çështjes penale të zhvilluar sipas ritit të gjykimit të shkurtuar, 1 (një) seancë paraprake për përfundimin e çështjes me objekt “Pushimin e procedimit penal”, 15 (pesëmbëdhjetë) seanca gjyqësore për përfundimin e çështjes civile me objekt “Pavlefshmëri titulli pronësie”, 1 (një) seancë gjyqësore për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, 1 (një) seancë gjyqësore për përfundimin e çështjes penale të zhvilluar sipas ritit të gjykimit të shkurtuar, 1 (një) seancë paraprake për përfundimin e çështjes me objekt “Dërgimin e çështjes në gjyq” dhe 2 (dy) seanca paraprake për përfundimin e çështjes me objekt “Dërgimin e çështjes në gjyq”.

Seancat përgjithësisht janë shtyrë për shkaqe të ndryshme (*për shkak të mosparaqitjes së palës së paditur, dhënien kohë palës paditëse për të përcaktuar dhe sjellë provat në formën e duhur ligjore, paraqitjen e provave të tjera; dhënien kohë të palës së paditur për të verifikuar deklaratimet e dëshmitarëve; për shkak të pamundësisë së gjyqtarës për arsye familjare; realizimin e aktit të ekspertimit; njohjen me aktin e ekspertimit dhe njoftimin e tij palës së paditur në mungesë; administrimin e provave të tjera shkresore; për marrjen e informacioneve nga të tretët, për t'i dhënë mundësi mbrojtësit të caktuar kryesisht të paraqitet në gjykim, paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare me shkrim, për shpalljen e arsyetuar të vendimit, etj*).

Në çështjet në të cilat seancat gjyqësore nuk janë çelur për shkak të mosformimit të trupit gjykues, përgjithësisht, rezulton që seancat vijuese të jenë planifikuar në një kohë të afërt dhe të jenë marrë masa efektive për të siguruar vijimin pa vonesë të gjykimit.¹⁴⁰ Konstatohet se në rastet kur palët apo përfaqësuesit e tyre janë bërë shkak për zvarritjen e gjykimit, gjyqtarja u ka bërë vërejtje, për të mos u përsëritur më e njëjta situatë.

¹³⁹ Duke përfshirë çështjen me nr. 198 vendimi, datë 27.07.2017 dhe çështjen me nr. 232 vendimi, datë 16.07.2018 për shkak se i përkasin kategorisë së çështjeve pa palë kundërshtare

¹⁴⁰ Në çështjen me nr. 967 vendimi, datë 10.11.2017, seanca e datës 08.11.2017 është shtyrë për në datën 09.11.2017 (pas 1 dite); në çështjen me nr. 998 vendimi, datë 15.11.2017, seanca e datës 06.11.2017 është shtyrë për në datën 10.11.2017 (pas 4 dite);

Caktimi i seancës së parë gjyqësore në ato raste kur parashikohet një detyrim ligjor për t'u respektuar (si afat maksimal), rezulton që gjyqtarja e ka respektuar afatin në të gjitha rastet (në tre çështjet e kategorisë seancë paraprake, gjyqtarja për caktimin e seancës së parë gjyqësore ka respektuar afatin 5 ditor të parashikuar në nenin 329/b apo në nenin 332/1 të K.Pr.Penale, të ndryshuar). Në çështjen me objekt “dërgim në gjyq”, rezulton se seanca e parë gjyqësore është caktuar brenda afatit 10 ditor të parashikuar në nenin 332/2 të K.Pr.Penale.¹⁴¹ Përgjithësisht, rezulton se seancat gjyqësore janë shtyrë brenda një afati në maksimum prej 20 - 30 ditësh nga njëra – tjetra në çështjet civile/familjare dhe deri në 14 ditë, konform nenit 342/2 të K.Pr.Penale, në çështjet penale. Vetëm në disa raste konstatohet lënia në një kohë të gjatë e seancës, për shkak të lejes vjetore në muajin gusht, apo në fund të vitit, periudhë që përkon me procedurën e mbartjeve të dosjeve nga administrata. Pra, në tërësi, shtyrjet e seancave kanë qenë për shkaqe objektive, të pavarura nga veprimet e gjyqtarës së çështjes.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, për treguesin “Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve me palë kundërshtarë të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është 5.3 seanca. Por, në kushtet kur gjyqtarja ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave joproductive, për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave, shkalla e aftësisë vlerësohet në një nivel më të lartë, duke e pikëzuar me 15 pikë.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “Numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive” aftësia e gjyqtarës për këtë tregues vlerësohet shumë e lartë, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

Referuar Raportit Analitik dhe dosjeve të përzgjedhura për vlerësim, rezulton se përgjithësisht gjyqtarja ka vënë në lëvizje çështjet duke marrë vendim për caktimin e seancës përgatitore dhe/ose gjyqësore pas caktimit të çështjes me short, duke iu referuar rregullave dhe gjykimit sipas kategorive të çështjeve. Konkretisht, në çështjet civile gjyqtarja është shprehur me vendim, si për njoftimin e akteve dhe kërkesës padisë palëve të paditura konform nenit 158 të K.Pr.Civile në funksion të lëshimit të deklaratës së mbrojtjes, ashtu edhe për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore (neni 158/b i K.Pr.Civile) e në vijim, pas ezaurimit të seancës përgatitore edhe për nxjerrjen e urdhrit për kalimin e çështjes në seancë

¹⁴¹ Neni 332 i K.Pr.Penale, pika 2 parashikon se “2. Nga data e depozitimit të kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq, deri në datën e seancës nuk duhet të kalojë një afat më i gjatë se 10 ditë”.

gjqësore (*neni 158/ç i K.Pr.Civile*). Në çështjet penale, konstatohet se gjithmonë gjyqtarja ka vënë dosjen në lëvizje brenda 5 ditëve, sikundër parashikohet në nenin 332/1 të K.Pr.Penale për çështjet e kategorisë seancë paraprake me objekt dërgimin e çështjes në gjyq, në nenin 329/b për çështjet e kategorisë seancë paraprake me objekt pushimin e procedimit penal, në nenet 333/1 dhe 406/dh të K.Pr.Penale, për çështjet e kategorisë penale themeli.

Në çështjet e përzgjedhura me short, gjyqtarja jo vetëm ka vënë në lëvizje dosjet në kohë dhe në përputhje me kërkesat dhe afatet ligjore, duke caktuar seancën, por ka treguar edhe kujdes maksimal në marrjen e masave për njoftimin e palëve, me qëllim zhvillimin e seancave gjyqësore efektive. Gjithashtu, rezulton se të gjitha veprimet procedurale gjatë shqyrtimit gjyqësor janë të dokumentuara. Drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt, sipas kërkesave procedurale të parashikuara në ligj për gjykimin në shkallë të parë, si në çështjet civile (*nenet 171 e vijues të K.Pr.Civile*), ashtu edhe në çështjet penale (*nenet 341 e vijues të K.Pr.Penale*) apo sipas ritit të gjykimit të zhvilluar (*nenet 405 e vijues të K.Pr.Penale në rastin e gjykimit të shkurtuar*), ose sipas ritit të gjykimeve të seancave paraprake (*neni 332/c i K.Pr.Penale*).

Gjatë gjykimit gjyqtarja tregon kujdes të posaçëm për verifikimin e paraqitjes së palëve, të mbrojtësve, relativin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqet e mosparaqitjes së palëve ose të pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, zhvillimin e gjykimit në mungesë të të pandehurit apo të të paditurve, shpalljen e trupit gjykues, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar, dhënien e fjalës palëve për parashtrimin dhe paraqitjen e fakteve dhe të provave, shtyrjen e seancave gjyqësore, duke pasqyruar shkakun në çdo rast, si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (njoftimin e palëve, kryerjen e komunikimit me institucionet e tjera, etj.). Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme, të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre dhe kur është rasti, edhe me arsyet e vendimmarrjes. Gjithashtu, rezulton që disa nga vendimet e ndërmjetëm janë të arsyetuar (*vendimi për pezullimin e gjykimit, vendim për ngritjen e çështjes nga pezullimi etj.*).

Në dosjet e vëzhguara, përgjithësisht, seancat e planifikuara janë çelur relativisht në kohë, por ndeshen disa vonesa të cilat variojnë nga 2 minuta, deri në 15 minuta (*vonesa të papërfillshme*). Edhe në ato pak raste kur vonesat kanë qenë deri në 15 minuta, gjyqtarja ka relatuar shkakun e vonesës, ku përgjithësisht ka qenë zgjatja e seancës paraarendëse.

Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, janë mbajtur me regjistrim audio, si dhe janë dokumentuar me shkrim nga sekretarja gjyqësore.

Në tërësi, referuar të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik dhe burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka kryer me efikasitet veprimet procedurale për

organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, duke respektuar afatet procedurale për zhvillimin e tyre, si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjykimit në kohë, me efikasitet dhe duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 20 pikë.

2.C Aftësia e gjyqtarës për të administruar dosjen gjyqësore.

2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se aktet e dosjes janë të renditura në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur përgjithësisht, të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Pavarësisht se nuk ka një rregullim që të përcaktojë në mënyrë të shprehur mënyrën e renditjes së akteve në dosjen gjyqësore, renditja duhet të jetë e tillë që të lehtësojë aksesimin e saj. Në rastin konkret, renditja sipas llojit të akteve procedurale, e ndërthurur edhe me veprimet procedurale të kryerja nga gjyqtarja gjatë gjykimit, është dhe konsiderohet si një mënyrë që e bën të lehtë dhe të aksesueshme dosjen. Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave (*njoftimet, shkresat, procesverbalet e seancave*). Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen pa asnjë vështirësi.

Në tërësi, rezulton se renditja akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin kronologjik, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të aksesueshme. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuar dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik rezulton se në dosjet e përzgjedhura me short ndodhen të gjitha aktet dhe dokumentacioni i administruar gjatë gjykimit. Në çdo dosje administrohen aktet shkresore të paraqitura nga palët ndërgjyqëse (*kërkesëpatria, provat, kërkesat dhe konkluzionet përfundimtare të palëve kur janë paraqitur me shkrim*), aktet e hartuara nga gjykata (*aktet e shortit, vendimi për kalimin e çështjes në*

seancë përgatitore, vendimi për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e seancave përgatitore dhe seancave gjyqësore, vendimet e ndërmjetme të arsyetuara, vendimet gjyqësore përfundimtare).

Nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara, apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit
97	Shkëlqyeshëm

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A Etika në punë

3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me të dhënat që mund të tregojnë cenimin e etikës apo përgjegjshmërisë në funksion të gjyqtarës u konstatuan këto të dhëna:

Referuar informacionit të përcjellë prej Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me shkresat nr. 3052/1 Prot., datë 30.12.2020 dhe nr. 3052/3 Prot., datë 14.01.2021, rezulton se për periudhën 01.01.2017-31.12.2019, për gjyqtaren {...} {...} janë paraqitur 2 (dy) ankesa, për të cilat pas verifikimit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimet nr.55/2 Prot., datë

22.01.2021 dhe nr. 56/2 Prot.,¹⁴² datë 26.01.2021 ka vendosur arkivimin e tyre, pas shqyrtimit fillestar. Lidhur me shkaqet e ankesave dhe rezultatet e verifikimit të tyre, referuar materialeve të dërguara nga ILD, rezulton si më poshtë:

I - Ankesa e shtetasit A.Q., depozituar në KLD me nr. 519Prot., datë 07.02.2018, regjistruar në Zyrën e ILD me nr. 55 Prot., datë 13.01.2021, konsiston në pretendimet për dhënien e një vendimi të padrejtë dhe joligjor.

ILD, pas verifikimit të ankesës, ka vendosur arkivimin e ankesës së ankuesit A.Q., me vendimin nr. 55/2 Prot., datë 22.01.2021, duke arsyetuar se: *“Pretendimet e ankueses se, vendimet për rrëzimin e kërkesave për sigurim padie të gjyqtarës {...}, janë të padrejta, joligjore janë pretendime të cilat zgjidhen mbi bazë apelimi gjyqësor nga një gjykatë më e lartë. Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk zëvendëson gjykatën më të lartë në kontrollin gjyqësor që i bëhet vendimmarrjes së gjykatë me të ulët. Nëse nga kontrolli gjyqësor rezultojnë shkelje të natyrës disiplinore, atëherë ato mund të përbëjnë shkak për fillim hetimi disiplinor. Në nenin 102 pika 2,shkronja a), të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, parashikohet “Shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit si magjistrat janë, veprimet, mosveprimet ose sjellja e magjistratit, a) që kanë të bëjnë me mosrespektimin e rëndë ose të përsëritur të legjislacionit procedural dhe material ose zbatimin e gabuar të legjislacionit procedural dhe material, kur konstatohet nga një gjykatë më e lartë”.....*

Sa më sipër, vlerësohet se, ankesa nuk plotëson kriterin e pranueshmërisë, bazuar në nenin 120, pika 1 shkronja dh) të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Për këtë shkak, ankesa duhet të arkivohet në zbatim të nenit 121, pika 2, shkronja a) të këtij ligji”.

II- Ankesa e shtetasit S.B., depozituar në KLD me nr. 537 Prot., datë 08.02.2018, regjistruar në Zyrën e ILD me nr. 56 Prot., datë 13.01.2021, konsiston në pretendime për zvarritjen e qëllimshme të procesit gjyqësor të çështjes penale nr. 276/9 akti, datë 28.04.2017.

ILD, pas shqyrtimit fillestar të ankesës, ka vendosur arkivimin e ankesës së ankuesit S.B., me vendimin nr. 56/2 Prot., datë 26.01.2021 duke arsyetuar se: *“Kohëzgjatja totale e gjykimit rezulton të jetë 1 (një) vit, 1 (një) muaj dhe 14 (katërmbëdhjetë) ditë në periudhën:28.04.2017-12.06.2018, jashtë afatit standard minimal të gjykimit të çështjeve penale të parashikuara në vendimin e KLD-së nr. 261/2, datë 14.04.2010 “Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve” i ndryshuar, Ankesi nr.1, pika 5/a. ndërkohë, referuar nenit 399/2 të K.Pr.Civile gjykimi i kësaj çështje është brenda afatit të arsyeshëm kohor prej 2 vjetësh të parashikuar në shkronjën d) të këtij neni. Nga përmbajtja e ankesës rezulton se, është marrë prova me ekspert kriminalist, procedurë e cila duket se ka ndikuar dukshëm në kohëzgjatjen totale të gjykimit. Afati total i gjykimit të kësaj çështje, nuk është i asaj mase sa të justifikojë pa asnjë dyshim fillimin e hetimit disiplinor ndaj magjistrates {...}. Vlerësohet që, rasti t’i*

¹⁴² Vendimet për verifikimin e ankesave janë dërguar nga ILD me shkresat me nr. 3052/4 Prot., datë 02.02.2021 dhe 56/4 Prot., datë 26.01.2021 dhe i përkasin ankesave të shtetasit A.Q. dhe S.B..

referohet Këshillit të Lartë Gjyqësor lidhur me vlerësimin etiko-profesional të magistratëve, sipas kërkesave të nenit 77 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Lidhur me pretendimet e ankuesit për korrupsion nga ana e gjykatës dhe prokurorisë, ato janë të natyrës përgjithëse, ndërsa ankuesi, në rast se disponon fakte apo të dhëna për faktin penal të pretenduar, ka detyrimin ligjor të paraqesë kallëzimin penal në organet kompetente...

Për sa më sipër, vlerësohet se, ankesa nuk plotëson kriteret e pranueshmërisë, bazuar në nenin 120, pika 1 shkronja dh) të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Për këtë shkak, ankesa duhet të arkivohet në zbatim të nenit 121, pika 2, shkronja a) të këtij ligji”.

Gjyqtarja dhe kryetari i gjykatës në Formularin e Integruar të Vlerësimit i kanë vlerësuar shumë të larta aftësitë e gjyqtarës në drejtim të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk ka shfaqur sjellje që mund të cenojnë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

***Shkalla e etikës në punë të gjyqtarës dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e etikës së gjyqtarës në treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 35 pikë.*

3.B Integriteti i gjyqtarës

3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjtëti.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, për periudhën 01.01.2017-31.12.2019, rezulton të jenë regjistruar pranë ILD-së dy ankesa, trajtuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimet nr.55/2 Prot., datë 22.01.2021 dhe nr.56/2 Prot., datë 26.01.2021, më të cilët është vendosur arkivimi i ankesave pas shqyrtimit fillestar, me arsyetimin se nuk plotësojnë kushtet e pranueshmërisë, për shkaqet e referuar në analizën e treguesit më sipër.

Nga tërësia e fakteve të parashtruara dhe të analizuara në vendimet e ILD, nuk rezultojnë të dhëna për cenim të etikës apo elementë të tjerë që ndikojnë në vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës, si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicie që të dëshmojë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtarës, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjtëtin dhe pritshmërinë e publikut.

Gjithashtu, nuk rezulton që ndaj gjyqtarës {...}, gjatë periudhës së vlerësimit të jetë dhënë apo zbatuar ndonjë masë disiplinore.

Në raportin e ILDKPKI, përcjellë pranë KLGJ me shkresën nr.373/23 Prot., datë 04.10.2021, konkludohet se *deklarimi i pasurisë është i saktë dhe në përputhje me ligjin; ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë; nuk ka kryer fshehje të pasurisë; nuk ka kryer deklarim të rremë dhe nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

Gjyqtarja dhe kryetari i gjykatës, lidhur me këtë tregues, e kanë vlerësuar aftësinë e gjyqtarës në nivel shumë të lartë.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicie që të dëshmojë për ekzistencën e shfaqjeve të pahijshme, cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarit, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë favor ose disfavor në lidhje me çështjet në gjykim, apo çdo sjellje tjetër që mund të cenojë integritetin e gjyqtarit.

Për sa më sipër, referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të cenojnë integritetin e gjyqtarit, gjyqtarja pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues, pasi prezumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjelljeve të pahijshme, apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit.

Shkalla e integritetit të gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e integritetit të gjyqtarës në treguesin “Shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 40 pikë.

3.C Paanësia e gjyqtarës

3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit pasqyruar në Raportin Analitik, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtarja në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave, apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të saj. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve të administruara në dosjet e gjykimit, si dhe të dhënave nga vetëvlerësimi i gjyqtarës.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e integritetit të gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares në treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se për periudhën e vlerësimit 01.01.2017–31.12.2019, janë paraqitur 5 (pesë) kërkesa për përjashtimin e gjyqtares, nga të cilat nuk ka asnjë kërkesë të pranuar për përjashtimin e saj nga gjykimi. Po kështu, rezulton se edhe vetë gjyqtarja ka paraqitur 11 (njëmbëdhjetë) kërkesa për heqje dorë, të cilat janë pranuar të gjitha.

Për këto arsye, për këtë tregues numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares është “I pakonsiderueshëm”, duke qenë se nuk ka asnjë kërkesë të pranuar për përjashtimin e gjyqtares nga gjykimi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit”, vlerësohet ky numër është “I pakonsiderueshëm”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtares {...} në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A Aftësia e komunikimit.

4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces përdor në përgjithësi fjalë të thjeshta dhe të drejtpërdrejta. I njëjti konstatim rezulton edhe nga aktet e dosjeve të përzgjedhura me short, përfshirë këtu edhe regjistrimet e seancave në sistemin audio.

Gjyqtarja dhe kryetari i gjykatës, lidhur me këtë tregues, e kanë vlerësuar aftësinë e gjyqtares në nivel shumë të lartë.

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente me palët dhe pjesëmarrësit në proces, duke treguar kujdes për të qenë e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk evidentohet asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale dhe për rrjedhojë, prezumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo të subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

***Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtarja dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” vlerësohet “I lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

4.B Aftësia për të bashkëpunuar.

4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Gjyqtarja dhe kryetari i gjykatës e kanë vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit të saj me kolegët është në nivel

maksimal, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale dhe përfshirjen në diskutime ligjore.

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B.b Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik nuk rezultojnë të dhëna negative për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore, ndërkohë që gjyqtarja dhe kryetari i gjykatës e kanë vlerësuar këtë tregues në nivel shumë të lartë, duke parashtruar se gjyqtarja ka komunikim etik, korrekt dhe mirëkuptues me administratën gjyqësore.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

4.C Gatishmëria e gjyqtarës për t’u angazhuar në veprimtari të tjera.

4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarës në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja {...}, gjatë periudhës së vlerësimit 01.01.2017-31.12.2019, ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e lehtësues dhe pjesëmarrëses. Konkretisht, rezulton se gjyqtarja {...} është angazhuar në aktivitete trajnuese si më poshtë:

- (i) Në cilësinë e lehtësueses në Programin e Formimit Vazhdues në 1 (një) aktivitet trajnues të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 2 ditë trajnimi;
- (ii) Në cilësinë e pjesëmarrëses në Programin e Formimit Vazhdues në 12 (dymbëdhjetë) aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 19 ditë trajnimi.

Duke iu referuar nenit 55, pika 9¹⁴³ të Rregullores së Shkollës së Magjistraturës, pjesëmarrja në programimin e trajnimit vazhdues në cilësinë e ekspertit ose lehtësuesit ka vlerë edhe për efekt të përmbushjes së detyrimit për ndjekjen e programit të trajnimit vazhdues, duke u përlllogaritur 1 ditë pjesëmarrje si ekspert e barabartë me 2.5 ditë si pjesëmarrës dhe 1 ditë pjesëmarrje si lehtësues me 2 ditë si pjesëmarrës. Referuar këtij parashikimi, rezulton se gjyqtarja {...}, gjatë periudhës trevjeçare të vlerësimit ka marrë pjesë në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës për 23 ditë në të gjithë periudhën e vlerësimit.

Për periudhën e vlerësimit nuk rezulton që gjyqtarja të ketë marrë pjesë në aktivitete profesionale jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin të drejtës civile dhe penale, gjithsej 13 aktivitete të zhvilluara për 23 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në të gjithë periudhën tre vjeçare.

Pjesëmarrja e gjyqtarës në trajnime dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, pjesëmarrja e gjyqtarës në aktivitetet trajnuese të Shkollës së Magjistraturës dhe trajnime vlerësohet nga 15-120 ditë, duke e pikëzuar me 20 pikë.

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarës për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja është angazhuar në programin e formimit vazhdues së Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e lehtësueses në 1 (një) aktivitet trajnues brenda Programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues

¹⁴³ Në nenin 55, pika 9 të Rregullores së Shkollës së Magjistraturës parashikohet se :”Për efekt të detyrimit ligjor për pjesëmarrje në aktivitetet e Formimit Vazhdues, përlllogaritja e ditëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të angazhuar si ekspertë, lehtësues dhe moderatorë do të bëhet si më poshtë:

- 1 ditë pjesëmarrjeje si ekspert është e barabartë me 2.5 ditë pjesëmarrje në trajnim;
- 1 ditë pjesëmarrje si lehtësues është e barabartë me 2 ditë pjesëmarrje në trajnim;
- 1 ditë pjesëmarrje si moderator është e barabartë me 1.5 ditë pjesëmarrje në trajnim.

Ky kontribut vlen vetëm për përlllogaritjen e ditëve si pjesëmarrës në Formimin Vazhdues dhe nuk sjell efekte financiare.”.

me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimi të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtaren {...} duke qenë se rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj në cilësinë e lehtësueses në një aktivitet trajnues në Shkollën e Magjistraturës, ky tregues pikëzohet me 5 pikë.

***Disponueshmëria e gjyqtares dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në treguesin “Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” rezulton disponueshmëria e gjyqtares, duke e pikëzuar me 5 pikë.*

4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtares në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, si dhe akteve të paraqitura nga gjyqtarja së bashku me kundërshtimet lidhur me këtë tregues, rezulton që gjyqtarja për periudhën e vlerësimit 2017-2019 të jetë angazhuar në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë, duke marrë pjesë në konferenca shkencore.

- Konkretisht, gjyqtarja në datën 19.12.2017, në bashkëpunim me Departamentin e së Drejtës Civile të Fakultetit të Drejtësisë, në Universitetin e Tiranës, ka prezantuar workshopin me temë “*Kuadri Ligjor dhe problemet praktike në lidhje me pasuritë e paluajtshme*”, punimi me temë “*Regjistrimi i së drejtës së pronësisë në regjistrat e pasurive të paluajtshme*”.
- Në datat 9 dhe 10 tetor 2018, gjyqtarja ka marrë pjesë në sesionin “*Kujdestaria alternative me bazë familjen- roli i gjyqësorit*” nga ekspertë të huaj të Organizatës ndërkombëtare Save the Children në Shqipëri (*me gjyqtarë të Gjykatës së Shkallës së Parë të Hagës dhe gjyqtar në pension në Gjykatën e Lartë Administrative Hollandë*), që konsistonin në diskutime mbi praktikën gjyqësore sa i përket kujdesit alternativ me bazë familjen në Shqipëri, problemet e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi dhe nevoja e përjasjes me standardet ndërkombëtare dhe përvoja ndërkombëtare.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtaren {...} duke qenë se rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësi, apo aktivitete të tjera, ky tregues pikëzohet me 5 pikë.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në treguesin “Angazhimi i gjyqtares në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë.

4.C.ç Publikimet ligjore akademike.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me angazhimin e gjyqtares në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, nuk rezultojnë të dhëna. Për pasojë, në mungesë të të dhënave për këtë tregues, gjyqtarja pikëzohet me 0 pikë.

Publikimet ligjore akademike dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në treguesin “Publikime ligjore akademike” nuk rezultojnë publikime të gjyqtares, duke e pikëzuar me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
95	Shkëlqyeshëm

**NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE
NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT**

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarës	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarës	97	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	95	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	392	Shkëlqyeshëm

PROPOZIME DHE REKOMANDIME

Bazuar në nenin 93, pika 5, shkronja “ç”, të Ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke iu referuar të dhënave të analizuarra dhe vlerësuarra në raport me kriteret e vlerësimit, rekomandohet që gjyqtarja {...} të mbajë në konsideratë angazhimin e saj të vazhdueshëm në aktivitete për trajnimin e gjyqtarëve, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale, si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit në këto fusha.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

SHTOJCA 1
KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE
NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTAREN {...}
PERIUDHA E VLERËSIMIT 1 JANAR 2017 - 31 DHJETOR 2019

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES			
Treguesit		Burimet	Shkalla e aftësisë
A. Njohuritë ligjore	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë
B. Arsyetimi ligjor	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë
2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES			
Tregues		Burimet	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit
A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë	a. Respektimi i afateve ligjore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	0-10%

	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	11-20%
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Mbi 93- 99%
	d. Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve
B. Aftësia e gjyqtares për të kryer procedural gjyqësore	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	1. Të dhënat statistikore/aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	Shumë e lartë

	gjqësor	2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	
C. Aftësia e gjyqtares për të administruar dosjen gjyqësore	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares	Shumë e lartë
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares	Shumë e lartë

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit
A. Etika në punë	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtares 3. Vetëvlerësimi i gjyqtares 4. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë
B. Integriteti i gjyqtares	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit 4. Të dhënat e raportit të ILDKPKI	Shumë e lartë
C. Paanësia e gjyqtares	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	1. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 2. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim	Shumë e lartë
	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuara të palëve për përjashtimin e gjyqtares	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	I pa konsiderueshëm

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Tregues	Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit
---------	--------	---------------------------------------

A. Aftësia e komunikimit	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	1. Vetëvlerësimi i gjyqtares 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	Shumë e lartë
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	1. Vetëvlerësimi i gjyqtares 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	I lartë
B. Aftësia për të bashkëpunuar	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	1. Vetëvlerësimi i gjyqtares 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	1. Vetëvlerësimi i gjyqtares 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë
C. Gatishmëria e gjyqtares për t'u angazhuar në veprimtari të tjera	a. Pjesëmarrja e gjyqtares në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	1. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës 2. Dosja personale e gjyqtares 3. Dokumente të dorëzuara nga gjyqtarja	5-40 ditë (Periudha 1/vjeçare)
	b. Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	1. Dosja personale e gjyqtares 2. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera	Ka të dhëna
	c. Pjesëmarrja e gjyqtares në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	1. Vetëvlerësimi i gjyqtares 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Dosja personale e gjyqtares 4. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të gjyqtares	Ka të dhëna
	ç. Publikimet ligjore akademike	1. Dosja personale e gjyqtares 2. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të saj	Nuk ka të dhëna
PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT		392	
NIVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARES		Shkëlqye	

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR